

Anita Angellovska
Glikerija Ilioska

HISTORIA DHE SHOQËRIA

4

KLASA

Historia dhe shoqëria

4 Klasa

Autore:

Anita Angellovska
Glikerija Ilioska

Recensentë:

Besa Havziu-Ismaili
Neda Jadrovska
Daniella Apostollovska

Ilustrimet: Anastasia Dimitrova

Redaktor: Solidar Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Dalibor Sandev

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Solidar Sulejmani, Mersim Fejza

Lektor: Refail Sulejmani

Rregullimi grafik dhe teknik: Leon Xhingo, Evgenija Pavlova ARS STUDIO

Botues: MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT
Rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Titulli i origjinal:

Историја и општество
4 одделение
Анита Ангеловска
Гликерија Илиоска

Shtypi: Evropa 92 Коџан

Tirazhi: 7.121

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2022

Me vendim për miratimin e tekstit mësimor në lëndën Historia dhe shoqëria për klasën 4 nr. 26-1515/1 të datës 03.11.2022 i miratuar nga Komisioni kombëtar teksteve mësimore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:94(075.2)=18
373.3.016:316.3(075.2)=18

ANGELLOVSKA, Anita

Historia dhe shoqëria 4 klasa / Anita Angellovska, Glikerija Ilioska ; [Ilustrimet Anastasia Dimitrova ; përkthyer nga gjuha maqedonase Dalibor Sandev]. - Shkup : Ministria për arsim dhe shkencë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2022. - 171 str. : илустр. ; 26 см

Превод на делото: Историја и општество 4 одделение / Анита Ангеловска, Гликерија Илиоска

ISBN 978-608-273-172-8

1. Ilioska, Glikerija [автор]

COBISS.MK-ID 58727941

SI TA SHFRYTËZONI KËTË LIBËR MËSIMOR

I nderuar nxënës,
E nderuar nxënëse,

Para juve është ky libër mësimor që përmban shumë materiale (përralla), fotografi, video, kuize, aktivitete dhe sfida, të cilat shpresojmë se do t'ju frymëzojnë të mendoni për bukuritë e vendit tonë, të kaluarën e tij dhe për rolin tuaj në shoqërinë dhe mjedisin në të cilin jetoni.

Shfrytëzimi i materialeve mësimore është i lehtë, i thjeshtë dhe argëtues. Ne dëshirojmë t'ju inkurajojmë që të merrni pjesë aktive në përvetësimin e njohurive dhe aftësive, qëndrimeve, vlerave dhe sjelljeve të reja. Përmes punës ekipore dhe bashkëpunimit ju do të hulumtoni, analizoni dhe bashkërisht do të nxirni përfundime.

Duke mësuar lëndën Histori dhe Shoqëri, pritet që ju, nxënësit të identifikoheni si qytetarë të vendit tonë; t'i respektoni të gjithë ata që jetojnë në të; të bëni dallimin midis sjelljes së përgjegjshme dhe të papërgjegjshme; të kujdeseni për mbrojtjen e mjedisit jetësor; të zhvilloni vlera dhe marrëdhënie të mira miqësore por edhe t'i identifikoni dhe kundërshtoni padrejtësitë e shkaktuara ndaj jush ose ndaj njerëzve të tjerë.

Ju dëshirojmë punë të këndshme dhe shumë suksese!

Autoret



Mësimdhënësi/
mësimdhënësja lexon



Shkruaj, përgjigju,
plotëso...



Tekst për njohuritë
themelore që duhet të
përvetësohen në orën
mësimore.



MOS HARRO!

Tekst që të ofron mësim nga jeta e përditshme.



MENDO DHE PËRGJIGJU

Pyetje dhe aktivitete të cilat do të të inkurajojnë të mendosh dhe ta përvetësosh përmbajtjen më lehtë.



HULUMTO

Pyetje të cilat do të të motivojnë për hulumtim.



AKTIVITET

Aktivitete që do t'i bësh në klasë të cilat do të ndihmojnë të zbulosh, hulumtosh dhe t'i zbatosh njohuritë e fituara.

PËRMBAJTJA

1

AMBIENTI IM

SI TA SHFRYTËZOSH KËTË LIBËR	3
ÇFARË ËSHTË MIQËSIA?	7
SI NDIKOJNË SHOKËT E MI NDAJ MEJE.....	10
UNË KAM MENDIMIN TIM.....	13
NEPOTIZËM	16
RYSHFETI DHE MITDHËNIA	19
SILLEM NË MËNYRË TË NDERSHME, TË DREJTË DHE KORREKTE	23
EMPATIA	28
STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET	31
SI SILLEM NDAJ SHOKËVE/SHOQEVE TË MIA	35

2

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

POPULLSIA DHE STRUKTURA E POPULLSISË.....	41
KOMUNA, VENDI I JETESËS	48
SIMBOLET E KOMUNËS	53
KRYETAR/E I/E KOMUNËS	57
KUJDESI I KOMUNËS PËR QYTETARËT	61
TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE NË KOMUN.....	64
ORIENTOHEM NË HARTËN GJEOGRAFIKE	69
SHENJAT HARTOGRAFIKE.....	74
VENDBANIMET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT.....	78
PARA HARTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT.....	82
VENDNDODHJA E VENDBANIMIT	97
VEPRIMTARITË EKONOSHOKE	99
NDËRLIDHJA E EKONOMISË ME KARAKTERISTIKAT NATYRORE TË VENDIT	104
SHFRYTËZIMI I PËRGJEGJSHËM I BURIMEVE NATYRORE	109
EKOLOGJIA	115
KLASIFIKIMI DHE RICIKLIMI I MBETURINAVE	119
EKO-HULUMTIMI	123

3

SHTETI IM

E KALUARA E SHTETIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS.....	127
KRYENGRITJA E ILINDENIT DHE REPUBLIKA E KRUSHEVËS.....	127
KAÇKM.....	134
REFERENDUMI I PAVARËSISË.....	140
SHKUPI – KRYEQYTET	143
INSTITUCIONET SHTETËRORE	149
SIMBOLET SHTETËRORE	153
KARAKTERI MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK I SHTETIT	156
KARAKTERI QYTETAR I SHTETIT	164
ORGANIZIMI CIVIL DHE VULLNETARIZMI.....	164
PJESËMARRJA AKTIVE, LIRIA E FJALËS, E DREJTA E PËRZGJEDHJES, BARAZIA	168



AMBIENTI IM

- 1 Çfarë është miqësia?
- 2 Si ndikojnë shokët e mi tek unë?
- 3 Unë kam mendimin tim
- 4 Nepotizmi
- 5 Ryshfeti dhe dhënia e mitos
- 6 Sillem në mënyrë të ndershme, të drejtë dhe korrekte
- 7 Empatia (ndjeshmëria)
- 8 Stereotipe dhe paragjykime
- 9 Si sillem ndaj shokëve/shoqeve të mia

TEMA 1

AMBIENTI IM

Rezultatet e të nxënit

Do të aftësohesh:

- të bësh dallimin midis miqësisë së vërtetë/ të sinqertë dhe miqësisë për përfitim;
- të dallosh sjelljen të papërshtatshme nën presionin e grupit dhe sjelljen e pamenduar që shpie në pasoja të padëshirueshme;
- të dallosh nepotizmin, rryshfetin dhe korrupsionin në shembuj (situata) të dhëna dhe të përmendësh shembuj për t'i parandaluar ato;
- të vlerësosh në mënyrë të duhur dhe të argumentuar normat gjinore të sjelljes dhe dhunën në bazë gjinore.

Gjithashtu, do të zhvillosh aftësi për:

- rezistencë ndaj presioneve sociale,
- dallim dhe reagim ndaj stereotipeve dhe paragjykimeve gjinore dhe ndaj dhunës me bazë gjinore.



ÇFARË ËSHTË MIQËSIA?



Miqësia është një nga gjërat më të bukura që mund t'i ndodhë një njeriu. Miqësia e vërtetë është kur ndihmoni dhe respektoni njëri-tjetrin dhe respektoni mendimin e tjetrit.



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Cilët janë shokët tuaj?
- Sa gjatë ekziston miqësia juaj?
- Me cilat veprime e tregoni miqësinë e ndërsjellë?
- Çfarë e dallon miqësinë e vërtetë? (shënoji karakteristikat e miqësisë së vërtetë)



AMBIENTI IM



Disa miqësi zgjatin tërë jetën, kurse disa miqësi mbarojnë në një moment të jetës.



AKTIVITET

Bëni një “Lule të miqësisë”. Petalet e luleve le të jenë inicialet e shokëve të tu. Gjethet e kërcellit le të jenë miqësi të prishura, të shënuara me simbole që ju kujtojnë personin. Çfarë ka më shumë në lulen tënde? Pse është kështu?



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Pse disa miqësi zgjatin për një kohë të gjatë?
- Pse disa miqësi ndërpriten?
- Cilat janë arsyet e ndërprerjes së një miqësie?
- Përshkruani karakteristikat e zilisë dhe lakmisë?
- Si ndikojnë këto karakteristika në miqësi?



HULUMTO !

Cila është arsyeja më e zakonshme për ndërprerjen e miqësive? Bisedo me shokët e klasës dhe anëtarët e familjes.

Gruponi arsyet dhe jep sugjerime se si t'i kapërceni ato.



MOS HARRO!

E vetmja mënyrë për të gjetur një shok është që edhe ti të jesh shok!



Kontrolloj se sa mësova
Pranë deklaratës me të cilën dakordohesh ose nuk
dakordohesh vendose shenjën ✓

Deklarata	Po	Jo
Ne duhet të respektohemi me miqtë.		
Unë respektoj mendimin e shokut/shoqes tim/e Unë i fali shokët e mi nëse gabojnë pa qëllim.		
Unë do të zemrohem me shokun/shoqen tim/e nëse ai/ajo nuk më lejon ta kopjoj detyrën e shtëpisë prej tij		
Do të zemërohem me shokun tim nëse ai/ajo nuk më lejon të kopjoj detyrat e shtëpisë.		
Shoku /shoqja im/ime më respekton.		
Nuk ka miqësi të përhjetshme.		



SI NDIKOJNË SHOKËT E MI NDAJ MEJE



Shiko ilustrimet dhe mendo nëse situatat e paraqitura janë pozitive apo negative dhe shpjegoni pse mendon kështu:



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- A mund ta identifikojmë veten në ndonjë nga situatat e përmendura?
- Trego disa situata të ngjashme me këto në të cilat je gjendur!
- Cili ishte roli yt?
- Kush të detyroi/të bindi ta bësh atë?
- Pse vendose të ndërmarresh një hap të tillë?
- Cilat ishin pasojat e sjelljes për ty dhe mjedisin?
- Çfarë mësimi/rekomandimi nxore nga veprimi i përmendur?



Shokët me sjelljen e tyre ndikojnë mbi njëri-tjetrin. Disa miqësi ndikojnë mbi ty pozitivisht dhe disa negativisht. Ndonjëherë ndodh që të bësh diçka kundër vullnetit tënd, vetëm që të mos zemërohen shokët e tu. Kundërshtoni propozimet me të cilat nuk je dakord. Ndonjëherë mund të dëshirosh të dallohesh përpara shokëve të tu dhe nganjëherë bën zgjedhje ose situatë të gabuar. Ki kujdes që të mos ofendosh ose lëndosh ndokënd. Shokët e vërtetë nuk duhet të kërkojnë nga ti që të bësh gjëra që do t'ju lëndojnë, ofendojnë ose poshtërojnë ty ose këdo, por nuk duhet as ti t'i kërkojnë shokëve të tu që të bëjnë të njëjtën gjë.



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Nëse di mbi ty ose mbi ndonjë shok tu ndonjë shembull, trego kur një grup miqësh ndikuan negativisht tek t'i ose te ndonjë shok yt.
- Mendo se si mund t'i kundërshtosh ndikimit negativ të disa shokëve mbi ty dhe në sjelljen tënde.
- A ke lënduar ndonjëherë ndonjë shok apo shoqe? Nëse po, shpjego si dhe pse ndodhi? Cilat ishin pasojat? Si u zgjidh situata?



AKTIVITET

Ndahuni në grupe. Secilin grup të zgjedhë një situatë që tregon se si njëri nga ju ishte nën ndikimin e moshatarëve të grupit dhe një situatë në të cilën njëri prej jush ishte iniciatori i sjelljes së papërshtatshme të grupit. Dramatizoni situatat dhe diskutoni rreth mënyrës se si duhet ta zgjidhni problemin.



HULUMTO

Bëj një anketë me shokët/shoqet e tu/a me pyetjen vijuese: Çfarë do të bësh nëse do t'ju sugjeroja të shkarravitim në murin e shkollës?

Diskutoni për secilën përgjigje.



Kontrolloj se sa mësova

1. Si do të veprosh me shokët/shoqet që duan të luajnë me top në klasë? (rretho ose shëno)

- a) do t'i tregoj mësuesit/mësueses
- b) do të bashkohem me ta sepse do të më zemërohen
- c) do t'u jap një sugjerim që pas shkollës të luajmë me top në fushë sporti, oborr ose në vend tjetër të sigurt për të luajtur
- ç) _____

2. Në qoftë se grup i shokëve propozon që të bëjmë diçka me të cilën nuk pajtohem, atëherë unë:

- a) do të largohem
- b) do të grindem
- c) do t'u bashkohem
- ç) do t'i bind ata që të mos e bëjnë një gjë të tillë

UNË KAM MENDIMIN TIM



Shiko ilustrimin, lexo shembullin dhe përgjigju pyetjeve :

Vëllai dhe motra e Amdiut i bien violinës shumë mirë. Babai i tij, gjithashtu, e regjistroi atë në orët e mësimit të violinës. Por Amdiu nuk është i lumtur. Atij i pëlqen të trajnojë karate.



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Pse nuk është i lumtur Amdiu?
- Në cilin rast do të ishte i lumtur?
- Si mund ta arrijë këtë?



Shiko ilustrimin, lexo shembullin dhe përgjigju pyetjeve :

Shokët e Verës ishin mërzitur. Ata ranë dakord të gjuanin llambën e ndriçimit në rrugës. Vera u shpjegoi se ashtu mund të lëndojnë ndonjë, të dëmtojë pronën shoqërore, por edhe se llamba është e nevojshme për të ndriçuar rrugën gjatë natës për shoferët dhe këmbësorët. Shokët vazhduan të gjuanin me gurë. Vera u largua prej tyre dhe u drejtua për në shtëpi. Ajo nuk iu nënshtrua bindjeve të tyre. Vera ka mendimin e saj për disa gjëra.





MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Pse Vera nuk e pranoi lojën e shokëve të saj?
- Çfarë do të thotë që të kesh mendimin tënd?
- Pse duhet të kesh mendimin tënd për disa gjëra?
- Në cilat situata e shpreh mendimin tënd për diçka?



Çdo njeri ka mendimin e tij për ndonjë situatë, aktivitet, interes në lidhje me miratimin ose mosmiratimin. Mendimi yt mund të dallohet nga ai i moshatarëve/shokëve tuaj të klasës. Është mirë që ta thuash mendimin tënd për diçka. Në të njëjtën kohë, ki kujdes që të mos ofendosh ndokënd, sepse mendimi i shprehur nuk duhet të ofendojë personalitetin e tjetrit, por duhet t'i dedikohet veprimit të tij. Është e rëndësishme të shprehësh mendimin tënd, nëse vëren se diçka është në kundërshtim me bindjet, mendimet ose interesat e tua dhe kur veprimet e dikujt çojnë në lëndimin ose fyerjen e dikujt ose diçkaje.



AKTIVITET

Debat „Unë mendoj se...“

Marku dhe Liridoni janë shokë. Një ditë, ndërsa po ecte nëpër park, Marku gjeti një portofol në bar. Ai e hapi atë dhe pa që në të kishte dokumente dhe para. Ai vendosi ta merrte me vete dhe t'i përdorte paratë e gjetura. Liridoni nuk u pajtua dhe u tregoi prindërve të tij. Veprimi i Liridonit a ishte i drejtë?

Lexo tekstin. Ndahuni në dy grupe: Grupi PËR dhe Grupi KUNDËR. Secili grup le ta mbrojë mendimin e tij: A ka vepruar drejtë Liridoni dhe pse grupi mendon kështu?



MOS HARRO!

Respekto mendimin e të tjerëve, nëse dëshiron që të respektohet edhe mendimi yt!



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Cili mendim i shokut tuaj nuk është pranuar ndonjëherë dhe pse?



Kontrolloj se sa mësova

1. Lexoji pyetjet, mendo dhe përgjigju në vijat e zbrazëta::

a) Fqinji i Vetonit ka një pemë molle në oborr. Maja dhe Jonuzi i propozuan Vetonit që të shkonin të vidhnin mollë.

– Si do të veproje t'i po të ishe në vendin e Vetonit?

b) Markoja propozoi që grupi i tyre i shokëve të mos fliste më me Kajën, sepse ajo nuk ia kishte dhënë detyrën e shtëpisë për ta kopjuar.

– Si do të veproje t'i sikur të ishe në vendin e shokëve të Markos?

2. Kur e them mendimin tim, nuk më intereson nëse dikush do të ofendohet apo do të lëndoj dikë. (rretho)

Po Jo


3. Qëndrimi im për hedhjen e mbeturinave në vendet publike është:

NEPOTIZMI



Lexoje tekstin dhe përgjigju pyetjeve:

Xhaxhi “A” dhe xhaxhi “B” janë miq. Xhaxhi “A” drejton klubin e hendbollit “Dielli” në të cilin stërvitet edhe vajza e xhaxhi “B”, “C”. Ndeshja me ekipin “Bletët” po afrohej dhe të gjithë ishin të ngazëllyer. Por... diçka nuk ishte siç duhej. “C” kishte dëshirë të madhe për të luajtur në ndeshjen vendimtare. Xhaxhi “B” vendosi të përmbushë dëshirën e vajzës së tij. Ai thirri xhaxhin “A” dhe në emër të miqësisë së tyre i tha që të përfshinte “C” në ndeshje. Xhaxhi “A” u indinjua. E dinte që “C” nuk punonte shumë dhe nuk stërvitej sa duhet kohët e fundit por këtu ishte dhe “Ç” që stërvitej shumë dhe me këmbëngulje dhe priste prej saj arritje të mëdha. Xhaxhi “B” ishte në mëdyshje si të vepronte.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Si e vlerësoni veprimin e xhaxhi “B”?
- Si u ndje xhaxhi “A”?
- Mbaro historinë dhe mendo:
 - Çfarë do të ndodhte nëse “C” nuk do të përfshihej në ndeshje? Dhe çfarë do të ndodhte nëse xhaxhi “A” e përfshinte “B” dhe e linte jashtë “Ç”?
- Në grafikun e dhënë shkruaj arsyet dhe pasojat e veprimeve të xhaxhi “B”:

“C” është përfshirë në ndeshje, “Ç” është lënë jashtë

Arsyeja: “C” nuk është përfshirë në ndeshje

Pasoja:

Pasoja:

- Cilat janë pasojat e veprimeve të tilla?
- Si mund t’u kundërvihemi situatave të tilla?



Kur dikush përpiqet të përdorë lidhjet me të afërmit ose shokët e tij për të arritur diçka në favor të tij, ne themi se ajo është nepotizëm. Nepotizmi është një fenomen negativ që përdoret më shpesh për të arritur sukses pa mundime.



AKTIVITET

Në fushën e zbrazët shkruani një shembull për nepotizëm dhe më pas diskutoni me shokët tuaj se si do të vepronit në vend të atij/asaj që arriti një qëllim pa meritë.



MOS HARRO!

Suksesi të cilin e arrini me punën tuaj është më i vlefshmi!



HULUMTO !

Bëj anketë me anëtarë më të rritur të familjes tënde: A kanë hasur ndonjëherë nepotizëm dhe si kanë reaguar në një situatë të tillë?



Kontrolloj se sa mësova
Pranë deklaratës me të cilën pajtohesh
ose nuk pajtohesh, vendos shenjën ✓

Deklarata	Po	Jo
Përdorimi i lidhjeve farefisnore për përfitime personale është dukuri negative.		
Pasoja nga nepotizmi është padrejtësi ndaj njerëzve të tjerë.		
Pranoj arritjen e suksesit pa dhënë mund.		

RYSHFETI DHE MITDHËNIA



Lexoje citatin, mendo dhe shpjego:

“Nëse miqësinë me dikë duhet ta blini, atëherë mos shpenzo fare.”
(autor i panjohur)



Lexo tekstin dhe përgjigju pyetjeve:

Dritarja e thyer

Fëmijët e lagjes sonë luanin futboll në oborrin para pallatit. Lina ishte me fat dhe shënoi gol.

– Gooooool! Gooooool! thërriste Arbëri, i cili u gëzua shumë dhe e përgëzoi.

Loja vazhdoi. Sanela dhe Nemanja nga ekipi kundërshtar vendosën të sulmojnë edhe më ashpër. Nemanja, i zemëruar për shkak të golit të Linës, e goditi fort topin. Askush nuk e pa se ku fluturoi topi, por të gjithë dëgjuan tingullin e thyerjes së xhamit. Nemanja i frikësuar shikoi dritaren e thyer. Ai e dinte që tani xhaxhi Ismaili do të zbriste në oborr dhe do ta qortonte. Papritmas i erdhi ideja për shpëtim...



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Ç' mendoni ju, cila ishte ideja e Nemanjës? (rretho shkronjën përpara përgjigjeve të ofruara):
 - A) Ta pranojë fajin para xhaxhi Ismailit
 - B) T'u ofrojë shokëve të tij që t'u blejë akullore thjesht vetëm për të mos i treguar xhaxhi Ismailit se kush e theu xhamin
 - C) Të gënjejë se xhamin nuk e theu ai
- Si e vlerëso idenë e Nemanjës që t'u blejë akullore shokëve të tij vetëm që të mos i tregojnë xhaxhi Ismailit?
- Si do të veprojë t'i sikur të ishte në vendin e Nemanjës?



Në incidentin që lexove, Nemanja u ofroi ryshfet shokëve të tij që të mos i tregonin xhaxhi Ismailit. Ai u përpoq ti korruptojë ata për ta arritur qëllimin e tij.

Ofrimi ose kërkimi i ryshfetit janë dukuri negative në shoqëri. Ryshfeti është ofrimi i një shërbimi ose i diçkaje materiale për ta arritur një qëllim. Të kërkosh ryshfet është të kërkosh diçka.



MENDO DHE PËRGJIGJU!


Mendo se cilat nga situatat e mëposhtme tregojnë dhënie ose marrje ryshfeti dhe përgjigju pyetjeve:

- A) Jovani dëshiron të shkojë të ngasë skateboard me shokët e tij, por nuk e ka shkruar detyrën e shtëpisë. Ai i ofron Linës ta mësojë se si të ngasë skateboard, nëse ajo ia shkruan detyrën e shtëpisë.
- A është kjo situatë ofrim apo pranim ryshfeti?
 - Si do të veprësh ti në atë situatë?
- B) Sedefi nuk dëshiron të shkojë në aksionin ekologjik në shkollë. Ajo bëhet sikur është e sëmurë. Ketit e di sekretin e saj dhe i kërkon që t'i japë çokollatë që të mos tregojë.
- A ofrohet apo pranohen ryshfet në këtë situatë?
 - Si do të veprësh ti në vend të Sedefit dhe si në vend të Ketit?



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Cilët shembuj mund të tregohen nga jeta e përditshme, kur hasim ryshfet dhe dhënie mito?
- Cilat janë pasojat e pranimit të ryshfetit dhe mitdhënies?
- Si duhet të veprosh kur has në një dukuri të tillë?



AKTIVITET

Ndahuni në dy grupe. Njëri grup le t'i shkruajë një letër Nemanjës në lidhje me veprimet e tij (nga teksti "Dritarja e thyer"), kurse grupi tjetër një letër për shokët e Nemanjës. Mendoni se çfarë do të shkruani në letër. Diskutoni për ato që shkruhen. Secilin grup le t'i shpjegojë pikëpamjet e tij.

Kur përdorim pozicionin tonë për të bërë një përfitim privat që është i paligjshëm, themi se është korrupsion. Ky lloj keqpërdorimi në shoqëri shfaqet në shumë forma, të cilat ndonjëherë janë të dukshme dhe më shpesh të fshehta. Nepotizëm, ryshfet, mitë, favorizim etj. janë korrupsion. Ne themi se personi që pranon dhe zbaton korrupsionin është i korruptuar. Kurdoherë që hasim korrupsion, duhet t'u tregojmë të moshuarve.



Kontrolloj se sa mësova

1. Afërdita dëshiron të jetë kryetare e klasës. Ajo u ofroi shokëve të saj fotografi për album nëse ata votojnë për të. Përcaktoni çfarë bëri Afërdita: (rretho)

- a) ofroi ryshfet
- b) mori ryshfet
- c) dëshiron të ketë më shumë shokë dhe shoqe
- ç) dëshiron të jetë e pëlqyer nga mësuesja


2. A duhet ta pranojnë shokët propozimin e Afërditës:

Po Jo

3. Korrupsioni është: (rretho)

- a) nepotizëm, ryshfet
- b) egoizëm
- c) mirënjohje, të qenët i shoqërueshëm
- ç) rruga më e lehtë gjer te sukcesi

SILLEM NË MËNYRË TË NDERSHME, TË DREJTË DHE KORREKTE



Mendo se cilat dukuri negative janë përshkruar dhe si kanë vepruar Mira dhe Lluka:

Mira huazoi një libër nga biblioteka e shkollës. Pa dashur, u gris një faqe e librit. Janja i sugjeroi që ai ta merrte fajin, por në këmbim ajo t'i jepte 50 denarë. Mira e dinte që duhej të ishte e ndershme dhe t'i thoshte punonjësës së bibliotekës se e kishte dëmtuar librin. Ajo nuk e pranoi propozimin e Janes.

Babai i Llukës është gjyqtar futbollit. Lluka ka ndeshje, por gjyqtar është babai i tij. Gjatë një mbrojtjeje, Lluka e preku topin me dorë. Babai i tij nuk gjykoj penallti. Lluka iu drejtua gjyqtarit tjetër dhe e pranoi gabimin.



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Vlerëso fillimisht veprimet e Janes dhe të babait të Llukës, kurse më pas të Mirës dhe Llukës!
- Si quhet tipari karakteristik kur pranon gabimin dhe dëshiron ta korrigjosh? Në cilat veprime nga shembujt e dhënë mund ta gjesësh atë?
- Përshkruaj një situatë në të cilën ndershmëria ishte më e rëndësishme se përfitimi!


AMBIENTI IM



Sjellje e ndershme është kur nuk pranon sukses, të cilin nuk e meriton dhe kundërshton çdo sukses pa punë.



Shiko ilustrimet dhe mendo se në cilat ilustrime tregohet zgjidhja e duhur :



MENDO DHE PËRGJIGJU !

- Si është zgjidhur rasti me fëmijë që nuk mund ta shikojnë ndeshjen?
- Si është zgjidhur rasti me vajzën në karrocë?
- Jep një shembull të sjelljes së drejtë!



Sjellja e drejtë është kur kujdesemi që të gjithë të jenë të kënaqur me vendimin e miratuar, që të gjithë të jenë të barabartë dhe pa hile.





Mendo se cilat janë pasojat nga situatat e paraqitura:



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- A është bërë dëmi qëllimisht?
- Si mund të shmangej dëmi?
- Si mund të korrigojohet dëmi i bërë?



Sjellja e drejtë është t'u përmbahesh rregullave të sjelljes në mjedisin tënd.

Sjelljet: ndershmëria, drejtësia dhe mënyra e duhur janë tiparet e karakterit pozitiv të njerëzimit. Ato të ndihmojnë të krijosh veten në një person që do të respektohet dhe vlerësohet.





HULUMTO

Si quhen karakteristikat që janë në kundërshtim me drejtësinë dhe ndershmerinë?



AKTIVITET

“Si do të gjykosh?”

Lexo tekstet “Shoku më i mirë” dhe “Kush je ti” dhe pastaj jep mendimin tënd se si do të gjykosh. Diskutoni me shokët e t’u për mënyrat se si do t’i zgjidhni situatat.

Shoku më i mirë

Joakimi është shoku im më i mirë. Ne jetojmë në të njëjtin pallat dhe jemi në të njëjtën klasë. Sot, Joakimi ia grisi Emës bllokun e vizatimit. Askush nuk e pa përveç meje. Ajo i tregoi mësuesit. Pasi i dëgjoi Joakimin dhe Emën, mësuesi më kërkoi të tregoja se çfarë kishte ndodhur. Si duhet të veproj?

Kush je ti?

Unë jam Dejani. A e dini se cili Dejan? Ai prej të cilit kanë frikë dhe dridhen të gjithë në klasë. Epo, më pëlqen shumë kur të gjithë më dëgjojnë dhe kanë frikë nga unë. Por... sot u zemërova shumë. Vendosa që në sheshin e lojërave të shkollës të pikturoj diçka me spërkatës me ngjyrë. Prita që të gjithë të shkojnë në shtëpi dhe fillova të vizatoj. Eh, çfarë fatkeqësie Meli më pa nga diku. Ajo i tregoi mësueses. Por unë jam Dejani, nuk pranoj asgjë, kështu që nuk i pranova asgjë mësueses. Dhe në pushim, e takova Melin. Vendosa një pengesë që të binte dhe i thashë bukur, qartë dhe me zë të lartë: “Kush je t’i që t’i thuash mësueses për mua? t’i vajzë pa vlerë!” Kështu i thashë, a kam të drejtë apo jo?



Kontrolloj se sa mësova

Pranë deklaratës me të cilën pajtohesh ose nuk pajtohesh, vendos shenjën ü ✓

Deklarata	Po	Jo
Sjellje e ndershme është kur shokut tënd i ofron dhuratë që ai të të ndihmojë.		
Mare, Mersiha dhe Lejla janë shoqe. Mare bleu akullore dhe ia dha Mersihës një topth akullore, ndërsa Lejlës ia dha dy toptha akullore. Mare nuk ka vepruar drejt.		
Sjellja e drejtë është kur t'i je i kujdesshëm që të mos e dëmtosh ose të mos e lëndosh dikë tjetër.		



EMPATIA



Shiko ilustrimet dhe përshkruaj se çfarë ndjeve derisa i shikojë:



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilën nga këto situata e ke përjetuar?
- Si ndihen njerëzit kur gjenden në një situatë të tillë?
- Çfarë mund të ndërmarrin atëherë?



Empatia është dhembshuri, të kuptuarit e ndjenjave të tjerëve. Kur një person ndjen empati, lind një dëshirë për të ndihmuar tjetrin. Empatia është tipar pozitiv njerëzor, i cili zhvillohet me edukimin e duhur të personit.



Janë dhënë disa situata. Lexoji dhe përpiku të përjetosh me situatën, respektivisht me fëmijën që është në situatë të caktuar. A e ngushëllon atë? Jepen disa situata. Lexoji dhe përpiku të tregosh ndjeshmëri me situatën, domethënë me fëmijën që është në situatë të caktuar. A e ngushëllon atë?

Nëse je përgjigjur po në shumicën e përgjigjeve, kjo do të thotë që je person empatik:

	SITUATA	PO	JO
1	Suzana erdhi në shkollë me këpucë të vjetra. Shokët e saj iu drejtuan me fjalë fyese dhe e përqeshnin. Suzana u ndje e poshtëruar dhe e ofenduar.		
2	Kirili nuk mund të mësojë kurrë të luajë shah. Një shok me të cilin luan u tha shokëve të tij të tjerë se Kirili nuk do të mësojë kurrë shah. Kirili filloi të qante.		
3	Vjollca çdo ditë në shkollë e mban “stilolapsin që i sjell fat”. Një ditë Mitja dhe Marvini ia morën atë dhe nuk donin t’ia kthenin. Vjollca i luste, por ata filluan ta përqeshin edhe më shumë. Vjollca filloi të qante me zë të ulët.		
4	Elvisi është fëmijë i shëndoshë dhe ka probleme me shikimin. Kate dhe Majlinda filluan të qeshnin kur ai nuk mund të lexonte ato që kishte shkruar mësuesi në tabelë. Elvisi ndihej i turpëruar dhe i lënduar.		



MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Si ndiheshin Suzana, Kirili, Vjollca dhe Elvisi ?
- Si do të veproje ti nëse do të kishte përreth teje fëmijë si Suzana, Kirili, Vjollca dhe Elvisi?





AKTIVITET

“Në këpucët e tjetrit“

Zgjidhni një nga situatat e treguara në ushtrimin e mëparshëm. Ndahuni në dy grupe. Njëri grup do të dramatizojë, kurse grupi tjetër do të ndjekë dramatizimin. Kur vlerëson se po ndodh diçka e papranueshme për ta, le të bërtasë STOP dhe ta përfundojë dramatizimin ashtu siç mendon se është e drejtë. Në fund, shpjegoni pse mendoni se zgjedhja juaj është e drejtë.



MOS HARRO!

Sillu me të tjerët ashtu si dëshiro që të tjerët të sillen me ty!



Kontrolluj se sa mësova

1. Milja u tall me Acen se nuk mund të vraponte shpejt. Acja u ofendua dhe filloi të qante. Majlinda i tregoi Miles se nuk ishte mirë të tallet. Ajo e përqafoi Acen dhe filloi ta ngushëllonte. I tha se do ta ndihmonte të stërvitej. Në rastin e përmendur, Majlinda tregoi kundrejt Aces:

- a) xheloz
- b) padurim
- c) empati
- ç) kuriozitet

2. Çfarë doni të bëni kur ndjeni ndjeshmëri?

- a) Dua të ndihmoj, por hezitoj
- b) E ngushëlloj, por bëj sikur nuk shoh
- c) I them dikujt tjetër që ta ndihmojë atë
- ç) Ndhimoj në maksimumin e aftësisë sime

STEREOTIPET DHE PARAGJYKIMET



Lexo pohimet dhe në fushat e zbrazëta shëno nëse je dakord ose nuk je dakord me pohimin. ✓/X:

1. Acja ka një mace. Ai nuk mund ta gjente macen për dy ditë dhe filloi të qante. Fqinja i thotë: “Ti je djalë dhe nuk duhet të qash”.

A je dakord me mendimin e fqinjës?

2. Denisi luan futboll me shokët e tij. Motra e tij dëshiron t'i bashkohet ekipit. Denisi i thotë: “Ti je vajzë. Vajzat nuk luajnë futboll”.

A je dakord me Denisin?

3. Sara dhe Damiri janë vëlla e motër. Çdo mëngjes kur përgatiten për në shkollë, Damiri i thotë Sarës: «Rregulloje edhe shtratin tim. Ti je vajzë dhe duhet të rregullosh shtretërit».

A jeni dakord me Damirin?

4. Toni e do shumë baletin. Ai bëri kërkesë për të marrë pjesë në orët e baletit. Shokët e tij tallen me të: “Baleti është për vajza. Ejani të stërvitemi në boks. Ai është për djem”.

A jeni dakord me shokët e Tonit?





MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Pse je dakord me shembujt e dhënë?
- Pse fëmijët në situatat e paraqitura sillen në këtë mënyrë
- Si dhe ku e mësuan atë?
- Cili është mendimi yt për këto pikëpamje?
- Jep disa shembuj të tjerë nga mjedisi yt për gjërat që ne mendojmë se vajzat guxojnë/duhet t'i bëjnë dhe djemtë jo dhe anasjelltas.

Ç'është stereotipi dhe ç'është paragjykimi?




Përpiqu të shtosh shembuj të stereotipit dhe paragjykit:

Stereotipi	Paragjykimi
Vajzat nuk janë sportiste të mira.	Shokët e Janës dhe Mersihës nuk i duan me vete në ekipin e basketbollit
Djemtë duhet të jenë të fortë, jo të ndjeshëm.	Në shfaqjen e shkollës, vajzat nuk e pranuan Damirin të merrte pjesë në pikën e baletit, megjithëse Damiri stërvitej shumë dhe i kryente të gjitha lëvizjet në mënyrë korrekte.
	Ndërsa po e rregullonin klasën, Velimiri tha: "Lërin vajzat të fshijnë dërrasën dhe të vendosin stolat në radhë, kurse ne djemtë do të shkojmë të luajmë futboll".
Ngjyra rozë është ngjyrë për vajza.	
	Shokët u tallën me Naumin kur ai ra dhe filloi të qante.



Nga shembujt e dhënë arrijmë në përfundimin se disa stereotipe çojnë në paragjykime. Paragjykimet zakonisht janë mendime/ndjenja negative ndaj dikujt pa e njohur personalisht. Paragjykimet bazohen në stereotipe. Stereotipet zakonisht janë qëndrime negative ndaj grupit, të cilit i përket personi, për të cilin paragjykojmë. Këto janë mendime të pajustificuara, të cilat mund të çojnë në sjellje të keqe ndaj të tjerëve.



AKTIVITET

Vizato një vizatim që është në kundërshtim me stereotipet e dhëna në ushtrimin e mëparshëm. Me fjalët poshtë vizatimit, shkruaje një pohim në kundërshtim me stereotipin. Për shembull: “Edhe vajzat janë sportiste të mira”, “Edhe djemtë qajnë”, etj.

Diskuto se çfarë ke vizatuar dhe pse e vizatuar atë.

MOS HARRO!

Njihu me personin para se të prano ndonjë stereotip.

HULUMTO !

Anketo anëtarë më të moshuar të familjes: Me çfarë stereotipesh ndeshen ata dhe si do të kontribuojnë ata për t'i tejkaluar ato stereotipe?



Kontrolloj se sa mësova

Përcakto cila nga deklaratat e dhëna është stereotip e cila është paragjykim, duke shënuar shenjën ✓ në kolonat përkatëse

Deklarata	Stereotip	Paragjykim
Femrat janë shofere të dobëta.		
Mehdiu nuk do të gatujë drekë të shijshme, sepse është mashkull.		
Meshkujt janë gjellëbërës të dobët.		
Hana nuk do të mundet ta drejtojë aero-planin, sepse është femër.		

SI SILLEM NDAJ SHOKËVE/ SHOQEVE TË MIA



Lexoje tekstin dhe përgjigju pyetjeve:

Magde mëson në klasën tonë. Ajo është nxënëse shembullore dhe e mirë, por në të njëjtën kohë dhe vrapuese e shkëlqyer në 100 metra. Por këtu janë edhe Johani dhe Denisi që gjithashtu, stërviten në atletikë.

Sot në klasë kishte garë vrapimi. Johani ishte i sigurt se do të fitonte, por garën e fitoi Magde. Johani u zemërua shumë. Ai u ndje i poshtëruar sepse miqtë e tij e ngacmonin pasi humbi nga një vajze. Gjatë pushimit, ai filloi t'i shkruante në telefon mesazhe fyese, kurse më vonë, së bashku me Denisin, shkuan te Magde dhe filluan ta fyenin. Ata gjithashtu filluan ta quanin me emra nënçmues. Johani nuk mund ta duronte humbjen nga “një vajzë”.



Erbeji është një djalë i imët, ai ka probleme me shikimin dhe gjithmonë rri ulur në bankën e parë. Jasnës, Sedefit dhe Mirës kjo gjë u pengonte. Një ditë ata ranë dakord t'ia lëviznin karrigen Erbejit ndërkohë që ai po ulej. Erbeji ra dhe në të njëjtën kohë i ranë syzet dhe u thyen. Vajzat qeshen, ndërsa Erbeji u turpërua dhe filloi të qante. Kjo ishte arsyeja që ata ta përqeshin edhe më shumë: “Erbeji nuk është djalë, djemtë nuk qajnë”.





MENDO DHE PËRGJIGJU!

- Si e vlerëson sjelljen e Johanit, Denisit, Jasnës, Sedefit dhe Mirës?
- Çfarë lloj dhune ndodhi në tekstin e parë, dhe çfarë lloj në tekstin e dytë?
- Cilët stereotipa çuan në dhunë verbale ose fizike?
- Jep një shembull kur ke marrë pjesë ose ke parë dhunë të ngjashme verbale ose fizike të shkaktuar nga ndonjë stereotip ose paragjykim!



Dhuna mund të jetë verbale ose fizike. Dhuna verbale ka të bëjë me thënien e fjalëve fyese, fyerjeve, kërcënimeve, etj. Dhuna fizike i referohet kontaktit fizik me qëllim të shkaktimit të lëndimeve fizike.

Paragjykimet shpesh çojnë në dhunë verbale ose fizike.



MOS HARRO!

Nga shembujt e dhënë, përcakto se çfarë lloj dhune është e pranishme dhe cili paragjykim është arsyeja për këtë:



Nga shembujt e dhënë, përcakto se çfarë lloj dhune është e pranishme dhe cili paragjykim është arsyeja për këtë:

1. Sofia e mundi “A”n në not. “A” u zemërua sepse ai u mund nga një vajzë dhe filloi ta fyente atë me fjalë të pahijshme.


Paragjykimi:

Lloji i dhunës:

2. Adnani erdhi në shkollë me një xhup të kuq. Ana dhe Dona u tallën me të dhe i thonin fjalë të pahijshme. Ata i thoshin se meshkujt nuk veshin rroba me ngjyrë të kuqe. Kur panë që Adnani nuk iu përgjigj provokimeve të tyre, Dona e shtyu nga prapa dhe Adnani ra nëpër shkallë.

Paragjykimi:

Lloji i dhunës:






Kontrolloj se sa mësova

1. Të shprehurit me fyerje dhe me fjalëve fyese ndaj dikujt është:
 - a) dhunë fizike
 - b) dhunë verbale
 - c) sjellje jo e dhunshme
 - d) mënyrë e shoqërimit

2. Mënyra më e mirë për ta zgjidhur një mosmarrëveshje është:
 - a) bisedë
 - b) dhunë fizike
 - c) lëshim pe
 - d) nënçmim

3. Mia gjithmonë i mban flokët të shkurtra. Leo thotë se nuk mund të durojë kur vajzat kanë “frizurë mashkullore”. Ai po bëhet gati që ta ofendojë atë. Si do të veprosht t’i në këtë rast:
 - a) do t’i sqaroj Leos se Mia ka të drejtë t’i shkurtojë flokët si të dojë vetë.
 - b) do ta mbështes dhe do të bashkohem me të në ofendimet e tij.
 - c) do t’i informoj anëtarët e bashkësisë së nxënësve për zgjidhjen e problemit.
 - d) do t’i them Mias që herën tjetër të mos i shkurtojë flokët ashtu.





MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

- 1 Popullsia dhe struktura e saj
- 2 Komuna, vendbanimi
- 3 Simbolet e komunës
- 4 Kryetar/e i/e komunës
- 5 Kujdesi i komunës për qytetarët
- 6 Trashëgimia kulturore dhe historike në komunë
- 7 Orientohem në hartën gjeografike
- 8 Shenjat hartografike
- 9 Vendbanimet në Republikën e Maqedonisë së Veriut
- 10 Pranë hartës së Republikës së Maqedonisë së Veriut
- 11 Vendndodhja e vendbanimit
- 12 Veprimtaritë ekonomike
- 13 Ndërlidhja e ekonomisë me veçoritë natyrore të tokës
- 14 Përdorimi i përgjegjshëm i burimeve natyrore
- 15 Ekologjia
- 16 Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave
- 17 Eko-hulumtimi

TEMA 2

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Rezultate e të nxënit

Do të aftësohesh:

- të përshkruash strukturën e gjinisë, moshës, arsimit dhe strukturën etnike të popullsisë në komunë dhe në vend;
- të përcaktosh vendndodhjen e vendbanimit tënd në hartë gjeografike;
- të njohësh simbolet e komunës, të përmendësh karakteristikat e saj, të shpjegosh se si ajo kujdeset për të gjithë qytetarët dhe të përshkruash mënyrën e zgjedhjes së kryetarit të komunës;
- të dallosh aktivitetet ekonoshoke dhe t'i lidhësh ato me faktorët (klima, relievi dhe burimet natyrore) që kontribuojnë në zhvillimin e tyre;
- të dallosh sjellje të përgjegjshme nga sjellja e papërgjegjshme ndaj mjedisit.
- të zhvillosh vetëdije ekologjike dhe të kujdesesh për mbrojtjen e jetësor.

POPULLSIA DHE STRUKTURA E SAJ



Në klasë erdhi një nxënëse e re, e cila quhej Anika. Kur u prezantua para shoqeve dhe shokëve të klasës, ajo tregoi se ishte nga Tetova. Duke e përshkruar qytetin e saj, ajo u shpjegoi shoqeve dhe shokëve se Tetova është një nga qytetet më të mëdha në Republikën e Maqedonisë së Veriut sa i përket numrit të popullsisë. Shoqet dhe shokët e klasës e pyetën mësuesen se çka nënkuptojmë me fjalën **popullsi**.

Të zbulojmë çka do të thotë fjala **popullsi**!



Popullsia është numri i njerëzve që jetojnë në një territor të caktuar.

Numri i popullsisë mund të llogaritet në nivel botëror, shtetëror, rajonal, në nivel qyteti, vendbanimi ose fshati. Kjo do të thotë se në një shtet të caktuar, qytet, fshat ose në ndonjë vend, jeton një numër i caktuar i njerëzve.

Numri i popullsisë ndryshohet çdo ditë, duke u rritur ose duke u zvogëluar. Numri i popullsisë në një shtet mund të vërtetohet përmes organizimit të regjistrimit të popullsisë.


MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Çfarë mendon, pse numri i popullsisë ndryshohet vazhdimisht?



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Në cilën mënyrë mund të dihet numri i popullsisë së një vendi?
- Shqyrto grafikunin e dhënë dhe radhiti qytetet sipas numrit të popullsisë duke filluar nga qyteti me popullsi më të madhe deri te qyteti me popullsi më të vogël.
- Cili qytet ka numër më të madh të popullsisë, sipas grafikunin të dhënë?
- Cili qytet ka më pak popullsi?
- Mendo, pse në një vendbanim të caktuar popullsia është më e dendur?



■ Shkup ■ Tetovë ■ Strumicë
■ Manastir ■ Ohër ■ Dibër



AKTIVITET

Në faqen e internetit të komunës sate, gjej se sa është dendësia e popullsisë në vendbanimin tënd. Krahasoje atë me dy vendbanimet më të afërta. Përpilo një grafikun, në të cilin do ta paraqesësh popullsinë e të tri vendbanimeve. Diskuto për arsyet të cilat kanë ndikuar në dallimet e numrit të popullsisë së këtyre vendbanimeve.



Bota është një vend i cili është i banuar nga njerëz të moshave të ndryshme, me gjuhë, gjini, arsim, besim të ndryshëm etj. Për ta kuptuar llojllojshmërinë e popullsisë do të të ndihmojë aktiviteti vijues:

Dil në oborrin e shkollës. Vëzhgo nxënësit dhe punonjësit e shkollës. Përgjigju pyetjeve vijuese:

- Në çka dallohen nxënësit dhe punonjësit në shkollë?
- Shkruaj të gjitha mënyrat e mundshme se si mund t'i klasifikosh ata. Mënyra se si i klasifikove ata tregon se në cilat mënyra mund të paraqitet struktura e nxënësve dhe e punonjësve të shkollës tënde.

Pyes veten, çka është struktura e popullsisë?



Struktura e popullsisë e pasqyron llojllojshmërinë e popullsisë në botë, shtet, rajon, qytet, fshat. ...

Ajo dallohet sipas:

- moshës
- gjinisë /seksit,
- përkatësisë etnike,
- nivelit arsimor etj.

Regjistrimi i popullsisë mundëson që të mësohet se sa është numri i banorëve në një shtet, por edhe se çfarë është struktura e popullsisë në atë shtet.

Struktura e moshës na tregon se cili është raporti ndërmjet grupmoshave (popullsia me moshë të re – deri 19 vjet, popullsia me moshë të pjekur – prej 2059 vjet, dhe popullsia me moshë pleqërie – mbi 60 vjeç) në një territor të caktuar.

Struktura gjinore është raporti midis popullsisë mashkullore dhe femërore në një territor të caktuar. Raporti midis popullsisë mashkullore dhe femërore në botë është pothuajse i barabartë.

Struktura etnike është përbërja e popullsisë sipas përkatësisë etnike të qytetarëve (përkatësia e një populli të caktuar). Për shembull, në Republikën e Maqedonisë së Veriut jetojnë populli maqedonas,



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

shqiptar, turk, vllleh, serb, rom, boshnjak dhe të tjerët. Të gjithë këta popuj kanë karakteristikat e tyre siç janë: gjuha, zakonet, tradita, feja etj. Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë Veriut kanë të drejta të barabarta, të garantuara me Kushtetutën.

Struktura arsimore paraqet nivelin e arsimit të popullsisë. Arsimi është një nga faktorët më të rëndësishëm për zhvillimin e një vendi. Prandaj, bëhen hulumtime të ndryshme për të mësuar se sa e arsimuar është popullsia dhe cili është niveli i saj i arsimit. Struktura arsimore e popullsisë mund të tregohet përmes:

- popullsisë së arsimuar/paarsimuar (analfabete) ose
- nivelit të arsimit (pa arsimim fillor, me arsimim fillor, të mesëm, të lartë dhe me nivele më të larta të arsimit).



AKTIVITET

Bëni një “regjistrim të klasës” në klasën tuaj, si në vijim:

- Zgjidhni një regjistruar/e.
- Së bashku krijoni një tabelë në të cilën regjistruar/ia duhet të fusë të dhënat vijuese për njërin prind/kujdestar të secilit/ës nxënës/e: moshën, gjininë, përkatësinë etnike dhe arsimin.
- Renditni të dhënat dhe shfaqni ato me ndihmën e diagrameve me kolona.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Përcakto se çfarë është struktura e moshës, e gjinisë, e përkatësisë etnike e arsimore në klasën tuaj sipas “Regjistrimit të klasës”.
- Çfarë përfundimesh nxjerr nga të dhënat e fituara?
- Krahasoni të dhënat tuaja me të dhënat e paraleleve të tjera. Çfarë është struktura e moshës, e gjinisë, struktura etnike dhe arsimore në paralelet e tjera?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



MËSO

Cili shtet në botë ka më shumë popullsi dhe cili më pak?
Cili është vlerësimi për numrin e popullsisë në mbarë botën?

Bota është një vend që vazhdimisht ndryshohet, zhvillohet dhe avancohet. Njerëzit lindin, shpërngulen, plaken, vdesin. E gjithë kjo kontribuon që numri i banorëve dhe struktura e popullsisë të mos jetë diçka e përhershme dhe sta-tike, por e ndryshueshme.



Hulumtimi zhvillon mendimin kritik.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Zbuloj se sa për qind e popullsisë ishte analfabete 50 vite më parë!
- Krahaso dhe mendo pse ka kaq shumë ndryshim krahasuar me të dhënat aktuale.
- Me ndihmën e mësimdhënësit/es, gjej në internet të dhëna rreth strukturës së popullsisë në komunën tënde. Paraqiti ato të dhëna me ndihmën e grafikoneve. Mendo se cila strukturë e popullsisë mund të ndryshojë më shpejt. Arsyeto mendimin tënd.
- Me ndihmën e mësuesit/ mësueses, hulumto cila është struktura e popullsisë në vendin tonë.



Kontrolloj se sa mësova


1. Çka na tregon struktura e popullsisë?

2. Struktura e popullsisë që na tregon se cili është raporti midis popullsisë së re, të pjekur dhe të vjetër e pasqyron:

- A) strukturën gjinore
- B) strukturën e moshës
- C) strukturën arsimore
- D) strukturën etnike

3. Struktura e popullsisë është e ndryshueshme në varësi të:

KOMUNA E VENDBANIMIT



Olivera dhe Almedini po përgatiteshin të merrnin pjesë në “Festivalin e luleve”. Këtë vit nikoqir i festivalit është komuna e tyre. Kjo do të thotë se të ftuarit e tyre do të jenë përfaqësues të komunave të tjera, që do të marrin pjesë me punimet e tyre prej luleve. Vëllai i Almedinit, Arbëri, nuk e dinte se çfarë do të thotë fjala komunë. Olivera u përpoq t’ia shpjegonte.

Komuna është bashkësi e banorëve të një rajoni të caktuar, të cilën e drejton administrata e përbashkët dhe Kryetari/kryetarja i/e komunës.

Qytetarët që kanë një vendbanim të përhershëm në territorin e një komune janë banorë të asaj komune. Banorët e komunës kanë të drejtë t’i parashtrojnë komunës propozime që kanë të bëjnë me çështje të rëndësishme (p.sh.: për çështjet ekologjike, furnizimin me ujë, ndriçimin publik, jetën kulturore dhe zbavitëse në komunë, çështjet arsimore, shëndetësinë etj.) Në mënyrë të tillë, ato kontribuojnë për një jetë më të mirë në komunë, por edhe për zhvillimin e saj.

Komuna është e përbërë nga disa vendbanime (qyteti dhe fshatrat përreth, një fshat më i madh me fshatra përreth ose një qytet i përbërë nga disa vendbanime, të cilat njëkohësisht janë edhe komuna), por gjithashtu mund të përbëhet edhe nga një vendbanim i vetëm.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Shembull:




Komuna e Manastirit
(Qytet me më shumë fshatra përreth)



Komuna e Plassnicës e përbërë prej një fshati të madh me fshatra përreth



Komuna e Vevçanit
(vetëm një vendbanim)



Qyteti i Shkupit i përbërë nga disa vendbanime komuna.

Republika e Maqedonisë së Veriut ka 80 komuna. Prej tyre, 10 komuna i takojnë qytetit të Shkupit.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Shiko hartën dhe trego se cilat komuna i ke vizituar ose njeh njerëz që jetojnë në to.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilat vendbanime i përkasin komunës sate?
- Cili është vendbanimi më i madh sipas popullsisë në komunën tënde? Cili është më i vogli?
- Gjej sa është sipërfaqja e komunës sate.
- Me cilat komuna kufizohet komuna jote?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ




Në hartën memece ngjyrose dhe emërto komunën në të cilën ti jeton.



AKTIVITET

“Të njihemi”

Me ndihmën e Google Translate, ose me ndihmën e shokëve tuaj nga bashkësitë e tjera etnike, zbuloni se si thuhet në gjuhët e tjera që fliten në komunën tënde: “Mirëdita”, “Përshëndetje” dhe “Unë quhem...”. Shkruaj fjalët në fletushkë. Secili prej jush le të tërheqë një fletushkë dhe le t’i thotë fjalët në gjuhën tjetër. “Njihuni mes vete” në sa më shumë gjuhë.



Shkup - komunat



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilat gjuhë fliten në komunën tënde?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



MËSO

- Cila është komuna më e madhe dhe cila është komuna më e vogël për nga sipërfaqja në Republikën e Maqedonisë së Veriut?
- Nga cilat vendbanime përbëhen ato?
- Cilat gjuhë fliten në to?



Kontrolloj se sa mësova

1. Komuna është njësi e vetëqeverisjes lokale dhe bashkësi e banorëve të një rajoni të caktuar. (Rretho)

PO JO

2. Komuna përbëhet nga: (rretho përgjigjen e saktë.)

- a) një vendbanim
- b) më shumë vendbanime
- c) një ose më shumë vendbanime

3. Kush mund të jetë banor i komunës?

4. Në cilën mënyrë banorët marrin pjesë në punët e komunës?

SIMBOLET E KOMUNËS



Në “Festivalin e Luleve” Olivera, Almedini dhe Arbëri vunë re se të gjithë përfaqësuesit e komunave mbanin flamuj të valëvitur të komunës nga e cila vijnë.

Almedin, shiko sa bukur duken flamujt e komunave. Ta gjejmë flamurin e komunës sonë! sugjeroi Olivera dhe filloi të kërkonte me shikim nëpër flamujt që valviteshin.

Ç’është flamuri i komunës?



Flamuri është simboli i komunës. Edhe stema është simbol i komunës. Në to janë të paraqitura karakteristikat më të rëndësishme të komunës. Simbolet e komunës dallohen nga simbolet shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Vështroni shembujt e mëposhtëm të simboleve të disa komunave dhe shpjegoni cilat tipare janë karakteristike për ato komuna.



Stema dhe flamuri i qytetit të Shkupit



Stema dhe flamuri i Komunës së Ohrit



Stema dhe flamuri i Komunës së Gjevgjelisë



Stema dhe flamuri i
Komunës së Gostivarit



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilat janë karakteristikat e komunës sate?
- Paramendoi se si duken simbolet e komunës sate sipas karakteristikave kryesore të komunës dhe vizatoji ato në fushat e zbrazëta ose në fletoren tënde.

Stema

Flamuri

- Dhe tani, kërko në faqen e internetit të komunës dhe zbuloj se si duken vërtet stema dhe flamuri i komunës sate.
- Krahaso paramendimin tënd dhe simbolet e vërteta të komunës. Ku është dallimi?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Ku dhe kur përdoren e simbolet komunës??



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Kur dhe ku përdoret flamuri në komunën tënde?
- Në cilat ngjarje e ke parë të vendosur flamurin e komunës sate?
- Ku e ke parë stemën e komunës sate?



Stema përdoret në dokumentet komunale. Flamuri vendoset në godinën e komunës dhe në institucionet e tjera të themeluara nga komuna. Flamuri vendoset në ditë feste, në manifestime kulturore-artistike, sportive, politike, shkencore dhe manifestime të tjera të organizuara nën ombrellën dhe interesin e komunës..



AKTIVITET

“Simbolet tona”

Paramendo sikur je banor i një komune të imagjinuar me emrin Dielli. Paramendo karakteristikat kryesore të komunës (malet, fushat me drithëra, lumin etj.). Tani vizato stemën dhe flamurin e komunës. Krahaso simbolet që i vizatove me vizatimet e shokëve të tu. Në një hamer, vizatoni një stemë dhe një flamur të përbashkët për komunën tënde të imagjinuar Dielli. Diskutoni se çfarë tjetër do t’u shtonit simboleve.



Kontrolloj se sa mësova

1. Stema dhe flamuri i komunës janë:
 - a) ngjarje të rëndësishme
 - b) simbole të komunës
 - c) simbole shtetërore
2. Në stemën dhe flamurin e komunës janë paraqitur _____ me të cilat karakterizohet komuna.
3. Idrizi dhe Gordana marrin pjesë në një garë ndërkombëtare në lëndën Shkencat natyrore. Ata janë nga Struga. A duhet të vendoset flamuri i komunës së tyre në këtë garë?

PO JO

KRYETARI/KRYETARE I/ E KOMUNËS



Përpara njerëzve të tubuar, në skenën u shfaq kryetarja e komunës, e cila mbajti fjalim përshëndetës për përfaqësuesit e komunave, garuesit dhe të gjithë të pranishmit. Arbëri u interesua se kush ishte gruaja të cilën e përshëndetën pothuajse të gjithë të pranishmit dhe fjalimin e së cilës e ndoqën me vëmendje të gjithë.

- Almedin, kush është kjo grua? – pyeti ai.
- Ajo është kryetarja e komunës sonë, – u përgjigj Almedini.
- Secila komunë a e ka kryetarien e saj?
 - Po, çdo komunë ka kryetar ose kryetare, – u përgjigj Almedini.
- Cili është roli i tyre? – pyeti Arbëri.

Almedini filloi të shpjegonte...

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Kryetari/kryetarja i/e komunës është Kryetari/kryetarja i/e një qyteti ose komune, i/e cili/a e përfaqëson komunën. Kjo do të thotë se ai/ajo është përgjegjës/përgjegjëse për punën e komunës dhe të gjitha organeve të saj. Çdo kryetari/kryetare duhet të kujdeset për funksionimin e drejtë të komunës dhe për zgjidhjen e problemeve që janë të rëndësishme për të. Ato janë çështje dhe probleme që lidhen me ekologjinë, mjedisin e shëndetshëm jetësor, kulturën, sportin, arsimin etj.

Banorët e komunës kanë të drejtë të japin propozime për zgjidhjen e problemeve në komunë.

Kryetari/kryetarja i/e komunës zgjidhet çdo katër vjet, përmes zgjedhjeve me votim të fshehtë. Të drejtë vote kanë të gjithë banorët e komunës që kanë mbushur 18 vjet. Të gjithë votojnë personalisht dhe sipas bindjes së tyre.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Kush është Kryetari/kryetarja i/e komunës sate?
- Çfarë ka ndryshuar në komunën tënde gjatë këtij viti? Pyeti më të rriturit se çfarë ka ndryshuar në komunën tënde në pesë vitet e fundit.
- Çfarë do të bëje për komunën tënde nëse do të ishe ti kryetari/kryetare i/e komunës?



Kushdo që kandidon për kryetar komune duhet të ketë të përpiluar një program, të cilin do ta prezantojë para qytetarëve të komunës. Në atë program, ai/ajo u ofron qytetarëve zgjidhjen e problemeve, por edhe përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë. Në ditën e zgjedhjeve, çdo banor/e i/e rritur i/e komunës ka të drejtë të votojë për përzgjedhjen e tij/saj për kryetar/kryetare të komunës. Votimi është i fshehtë dhe i lirë, që do të thotë se askush nuk ka të drejtë të ndërhyjë në përzgjedhjen e qytetarit ose të dijë se për kë ka votuar votuesi/votuesja. Kjo është e drejtë demokratike e çdo qytetari/eje.



AKTIVITETI

"Zgjedhim kryetarin/kryetaren e komunës"

Përgatit një program për kryetar/kryetare komune, me të cilin do të prezantohesh para votuesve. Prezanto programin para shokëve dhe shoqeve "votues/e". Ki kujdes se çfarë propozon në program dhe cilat probleme në komunë premtan t'i zgjidhësh. Së bashku përpiloni një listë të votuesve. Bëni një kuti votimi dhe zgjidhni tre anëtarë të këshillit votues. Votuesit votojnë në mënyrë të fshehtë. Secili që ka votuar shënohet në listën e votuesve. Në fund të votimit, anëtarët e komisionit i numërojnë votat. Pasi e keni zgjedhur "kryetarin/kryetaren e komunës", diskutoni pse fitoi pikërisht ai/ajo dhe programi i tij/saj.



PËRGATITU PËR ORËN E ARDHSHME

Mendo për problemet me të cilat përballen qytetarët e komunës suaj. Parashtro pyetje dhe kërkoni një propozim për zgjidhjen e tyre nga qytetarët e komunës. Organizoni një vizitë në komunën tuaj. Ndahuni në grupe dhe përgatitni pyetje për kryetarin/kryetaren dhe stafin e komunës. Pyetjet le të jenë në lidhje me problemet dhe zgjidhjen e tyre në komunën tuaj:

- mjedisi jetësor
- shëndetësia
- arsimi
- mbështetje për personat me pengesa, të moshuarit dhe të varfrit
- kultura dhe sporti



Kontrolloj se sa mësova

1. Kryetari/Kryetarja i/e komunës është përgjegjës/e për:
 - a) zgjidhjen e problemeve në komunë dhe përmirësimin e jetës në të
 - b) nënshkrimin e dokumenteve
 - c) ndërtimin e rrugëve
 - d) Të gjitha të përmendurat më lart
2. Cilët banorë të komunës mund të ushtrojnë të drejtën e tyre për të votuar?

3. Në ditën e zgjedhjeve për kryetar/kryetare komune, Maria donte ta kontrollonte se për kë voton Mensuri. A e shkel me këtë veprim Maria të drejtën e Mensurit për votimit të fshehtë?

Po Jo
4. Çfarë duhet të përmbajë programi i kryetarit/kryetares kur ai/ajo kandidon në zgjedhje?



KUJDESI I KOMUNËS PËR QYTETARËT



Pas përfundimit të “Festivalit të luleve”, Almedini, Olivera dhe Arbëri vendosën të vizitojnë komunën dhe të njihen më për së afërmi me punën dhe detyrat e kryetarit/kryetares dhe punonjësve të komunës. Ata u nisën drejt godinës komunale dhe u paraqitën te kryetari/kryetarja i/e komunës. Olivera dhe Almedini tashmë kishin përgatitur pyetjet, të cilat do t’i parashtronin. Disa nga ato pyetje ishin:

- Si përballet komuna jonë me ujërat e ndotura?
- Si bëhet klasifikimi i mbeturinave në komunën tonë?
- Si i inkurajon komuna nxënësit e talentuar?
- Si kujdeset komuna për njerëzit me nevoja të veçanta?
- Çfarë ndërmerr komuna për njerëzit e moshuar?
- Si kujdeset komuna për zhvillimin e sportit dhe kulturës?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



MENDO DHE PËRGJIGJU

Në tabelën e dhënë shënoni pyetjet tuaja që i keni përgatitur dhe përgjigjet që i keni marrë gjatë vizitës së Komunës.

Grupi:	
Pyetjet	Përgjigjet

Diskutoni së bashku përgjigjet që i keni marrë nga kryetari/kryetarja dhe punonjësit e komunës.

- Cilat gjëra pozitive i mësuat?
- Cilave probleme në komunë duhet t'u kushtohet më shumë vëmendje?
- Në çfarë mënyre mund të kontribuosh për zgjidhjen e problemeve në komunën tënde?
- Çfarë do të ndërmerre rreth problemeve të zbuluara nëse ti do të ishe kryetar komune?

Problemi	Propozimi për zgjidhjen e problemit në komunë

Shkruaj propozimet tuaja në formë të kërkesës dhe parashtroni ato në komunën.



AKTIVITETI

“Zgjidhim problemin”

Ndahuni në dy grupe. Mësimdhënësi/ja parashtron një problem i cili paraqitet në komunën tuaj dhe ju duhet ta mendoni zgjidhjen e problemit. Secili grup e shpreh qëndrimin përmes përfaqësuesit të tij. Diskutoni se zgjidhja e kujt është më e mirë dhe më praktike për ta realizuar. Shkruaj sugjerimet në një hamer dhe vendoseni atë në klasë. Në fund të vitit shkollor kontrolloni se cilat nga zgjidhjet e problemeve janë realizuar në komunën tuaj.



Kontrolloj se sa mësova

1. Komuna është e obliguar të kujdeset për mjedisin jetësor, shëndetin, arsimin, të sigurojë mbështetje për personat me pengesa në zhvillim, për të moshuarit dhe të varfërit, për kulturën dhe sportin në komunë.

Po Jo

2. Në një lagje, banorët vunë re se koshi i plehrave, i vendosur në park, ishte i stërmbushur. Fëmijët që luanin në park filluan të hedhin mbeturinat pranë koshit, por edhe në bar. Si duhet të veprohet në situatën e përshkruar?

3. Kush është përgjegjës për mbeturinat e grumbulluara?

- a) komuna
- b) banorët
- c) komuna dhe banorët

4. Harisi është fëmijë që përdor karrocë për të lëvizur. Ai nuk mund të lëvizë në trotuare, sepse aty ka automjete të parkuara. Si duhet të veprohet në rastin e përshkruar?

5. Kush është përgjegjës për këtë situatë?

- a) komuna
- b) banorët
- c) komuna dhe banorët

TRASHËGIMIA KULTURORE DHE HISTORIKE NË KOMUNËN

Duke u kthyer nga vizita e realizuar në komunë, Oliverës i mbeti një çështje e pasqaruar. Ajo iu drejtua Almedinit:

- Almedin, harrova ta pyes kryetaren e komunës, a ekziston trashëgimi kulturore-historike në komunën tonë dhe si kujdeset komuna për të?
- Çfarë do të thotë trashëgimia kulturore dhe historike? – pyeti Arbëri.




Trashëgimi kulturore janë mbetjet materiale dhe jo materiale të së kaluarës të trashëguara nga paraardhësit tanë (objekte, ndërtesa dhe gjësende të vjetra, monumente kulturore dhe historike, vepra arti, këngë dhe valle popullore, veshje dhe qëndisje popullore, tradita, rite fetare, festa, zanate etj.)
Për shembull:



Muzeu i alfabetit të gjuhës shqipe



Vendi arkeologjik Heraklea, Manastir



Karnavali i Vevçanit



Xhamia e larme, Tetovë


MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Ohri, qyteti i vjetër



Manastiri i Shën Jovan Bigorskit,
rajoni i Dibrës

Gdhendje, Ohër



Ura e Gurit, Shkup



Kokino



Çarshia e vjetër e Shkupit



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

- Hëmmm, ejani të zbulojmë se me çfarë trashëgimie kulturore dhe historike është e pasur komuna jonë! – propozoi Almedini.
- Si do ta bëjmë këtë? – pyeti Olivera.
- Unë propozoj ta pyesim mësimdhënësin/en e historisë në shkollën tonë të na tregojë se cilat objekte dhe ndërtime të vjetra ekzistojnë në komunën tonë, dhe pastaj të hulumtojmë në internet, – tha Almedini. – Ne mund t'i vizitojmë dhe t'i fotografojmë ato.
- Unë propozoj që të shkojmë në muze dhe t'i kërkojmë kustosit të na shpjegojë për gjësendet e vjetra dhe veprat artistike që ndodhen në muze, – tha Olivera.
- Ndërsa unë meqenëse jam më i riu dhe nuk shkoj në shkollë, do t'i pyes gjyshërit e mi për zakonet dhe traditat, – tha Arbëri..



Kalaja Samuilit,
Ohër



MËSO

Trashëgimia kulturo-historike është një karakteristikë e një populli, i cili identifikohet përmes saj.

Hulumto me çfarë trashëgimie kulturore dhe historike është e pasur komuna jote.

- Ndahuni në grupe.
- Dakordohuni për rregullat e grupeve.
- Zgjedhni nga një shok, i cili do të prezantojë në fund të hulumtimit. Gjithashtu, zgjedhni një shok që do të fotografojë atë që po e hulumtoni.
- Secili grup le të hulumtojë për::
 - monumentet kulturore dhe historike, objektet dhe ndërtimet e vjetra;

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

- veprat artistike dhe gjësendet e vjetra;
 - zakonet, traditat, ritet fetare dhe festat;
 - këngët dhe vallet popullore, instrumentet popullore, veshjet dhe zanatet popullore.
- Hartoni një plan hulumtues. Mos harroni të planifikoni edhe materialet që do t'ju nevojiten për hulumtimin.
 - Mendoni se nga cilat burime mund të mësoni dhe të mblidhni sa më shumë informata. Për këtë qëllim mund t'ju ndihmojnë mësimdhënësit e historisë, banorët më të vjetër të komunës, Kryetari/kryetarja dhe punonjësit e komunës, kustosët e muzeve, informacionet e siguruar nga interneti, artistët etj.
 - Planifikoni cilat pyetje do t'i parashtroni kur të zhvilloni një intervistë ose anketë me njerëz që do t'i intervistoni ose anketoni.
 - Mbani ditar për aktivitete.
 - Në fund të hulumtimit, përmbledhni informacionin e marrë dhe bëni një prezantim, video ose prezantoni kërkimin tuaj përmes një broshure. Kuptohet, prezantoni rezultatin e punës suaj para komunitetit lokal, shkollës dhe banorëve të komunës suaj.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Vendi arkeologjik
Stobi, Gradsko



Kalaja e Samoilit Ohër



Kontrolloj se sa mësova

1. Në komunën time ekzistojnë këto trashëgimi kulturore dhe historike:

2. Për cilën festë të bashkësisë tjetër etnike di se si festohet?

3. Deri më tani kam vizituar këto objekte/ lokalitete kulturore dhe historike:

4. Pse duhet të kujdesemi për trashëgiminë kulturore dhe historike?

ORIENTOHEM NË HARTËN GJEOGRAFIKE



Leoni, Violeta dhe Zejne janë bjeshkatarë. Ata shpesh bëjnë bjeshkatarë në të gjithë vendin. Ata vizitojnë malet, por nganjëherë duan të njihen edhe me vendet e tjera të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Pjesë e pashmangshme e pajisjeve të tyre, përveç çantës së shpinës për bjeshkë, janë harta gjeografike dhe busulla.



Mendo: Pse Leoni, Violeta dhe Zejne kanë nevojë për hartë dhe busull kur ecin në këmbë?



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ




Ekzistojnë shumë lloje të hartave. Disa prej tyre janë:



– **Harta gjeografike**, e cila është e zvogëluar dhe paraqet fotografinë e përgjithësuar të të gjithë sipërfaqes tokësore ose ndonjë pjesë të saj të treguar në një sipërfaqe të rrafshët.

– **Harta hidrografike**, që tregon sipërfaqet ujore të një rajoni ose të një shteti të tërë.


MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



- **Harta ortografike**, në të cilën paraqiten malet e një rajoni ose të një shteti të tërë.



- **Hartat rrugore**, në të cilat paraqiten rrjeti rrugor dhe ai hekurudhor..



- **Harta e relievit**, në të cilën paraqitet relievi i sipërfaqes së Tokës.



DETYRË

Zbulo edhe sa lloje të tjera të hartave ekzistojnë.

Për çfarë lloji të hartave do të kenë nevojë Leoni, Aneta dhe Zejne kur bëjnë bjeshkatari?



Ti tashmë e di se anët kryesore të botës janë: lindja, perëndimi, veriu dhe jugu. Përveç anëve kryesore, ka edhe anë të ndërmjetme që na ndihmojnë të orientojemi më lehtë. Ato janë:

Verilindje - VL

Veriperëndim - VP

Juglindje - JL

Jugperëndim - JP



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Çdo hartë gjeografike i ka elementet e saj. Ato janë **emri** i shtetit ose territorit, i cili është paraqitur në hartën gjeografike, **shkalla** dhe **legjenda**.



Kujtohu në atë që ke mësuar në orët e shkencave natyrore:

- Çfarë tregon shkalla e hartës?
- Çfarë tregon relievi?
- Përmes se paraqitet relievi në hartën gjeografike.

Legjenda e hartës gjeografike na tregon simbolet që shënojnë objektet gjeografike në hartë. Legjenda e hartës gjeografike përmban shenja hartografike, ngjyra hartografike dhe elementë të tjerë, varësisht se për çfarë qëllimi është e dedikuar harta.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Në hartën gjeografike, përcakto se cili qytet është më afër vendbanimit tënd. Në cilën anë kryesore ose dytësore të botës ndodhet ai qytet?
- Çfarë tregon legjenda në hartën gjeografike? Mundohu ta lexosh.






DETYRË

Gjeje vendbanimin tënd (qytetin, fshatin, lagjen) në GoogleMap, Google Earth ose në hartën gjeografike. Përcakto në cilën pjesë të Republikës së Maqedonisë së Veriut ndodhet ai?




Kontrolloj se sa mësova

1. Cilat elemente përmbahen në hartën gjeografike?
 - a) emri i shtetit ose i zonës së paraqitur, legjenda, shkalla
 - b) vetëm sipërfaqet ujore të shtetit
 - c) legjenda dhe shkalla
2. Në hartën “memece” shkruaj anët kryesore dhe të ndërmjetme të botës.



3. Pse duhet t'i dimë anët e botës gjatë leximit në një hartë gjeografike?

SHENJAT HARTOGRAFIKE



Leoni, Violeta dhe Zejne planifikojnë të vizitojnë malin Baba. Ata duan të ngjiten në majën më të lartë të këtij mali. Leoni hapi hartën gjeografike dhe filloi ta kërkonte malin. Ai drejtoi gishtin drejt një vendi afër qytetit të Manastirit.




MENDO DHE PËRGJIGJU

Si e dinte Leoni ku ta gjente malin Baba në hartën gjeografike?

Për ta lexuar më lehtë hartën gjeografike, duhet t'i njohim dhe t'i dallojmë shenjat hartografike të cilat janë dhënë në legjendën e hartës.

Çdo shenjë e legjendës paraqet simbol grafik që tregon ndonjë element në sipërfaqen e tokës. Këto shenja janë të standardizuara, që do të thotë se ato përdoren dhe janë të njohura në nivel ndërkombëtar.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRË

Ndërlidhi fotografitë përkatëse me shenjat hartografike.



a.

1.




b.

2.



c.

3.




ç.

4.



d.

5.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRË

- Gjeje malin Baba, të cilin Leoni e kërkonte në hartë. Zbulo si quhet dhe sa është e lartë maja në të cilën Leoni, Violeta dhe Zejne donin të ngjiteshin.
- Gjeje vendbanimin tënd në hartën e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Zbulo se cilat janë shenjat hartografike përreth tij dhe emërtoji ato.
- Sipas shenjës hartografike përcakto përafërsisht numrin e banorëve të vendbanimit tënd.
- Në hartën memece shënoje vendbanimin tënd me shenja hartografike.






Kontrolloj se sa mësova

1. Çfarë përmban legjenda e hartës gjeografike?

2. Nën secilën shenjë gjeografike, shkruaj se çka tregon ajo:







3. Renditi objektet që i zbulove në afërsi të vendbanimit tuaj, sipas shenjave hartografike:

VENDBANIMET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Duke u ngjitur në majën e Pelisterit të malit Baba, Leoni, Violeta dhe Zejne u mahnitën me natyrën dhe pamjen e saj. Para tyre shtriheshin malet, kodrat, ndërsa atje diku larg dukeshin edhe ultësirat.

– Çfarë pamje e bukur! – tha Zejne. – Mendoj se atje në ultësirë shoh një vendbanim.

– Po, me siguri ai është Manastiri, – u përgjigj Leoni.

– Sipas madhësisë, mendoj se është një qytet, por ka edhe vendbanime më të vogla, – tha Zejne.

– Mendoj se duhet të shikojmë në hartë dhe të zbulojmë se çfarë lloj vend-banimi është ai që e shohim. A është fshat apo qytet? Në fakt, ne i dimë shenjat hartografike për fshatin dhe qytetin, kështu që do ta kemi lehtë ta zbulojmë, – tha Violeta.



Kujtohu: Cilat janë shenjat hartografike për fshatin dhe qytetin?



HULUMTO

Në hartë, sipas shenjave hartografike, gjej vendbanimet që Leoni, Zejne dhe Violeta i panë përreth Malit të Baba!

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Vendbanimet i dallojmë si qytete (vendbanime të mëdha) dhe fshatra (vendbanime më të vogla). Ekzistojnë edhe vendbanime që janë pjesë e qytetit. Një qytet më i madh përbëhet nga më shumë vendbanime.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut zyrtarisht janë të njohura 34 qytete dhe 1 645 fshatra.



Harta e qyteteve në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Sipas vendit ku janë ndërtuar, vendbanimet mund të jenë fushore, kodrinore, malore dhe kodrinomalore. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekzistojnë lloje të ndryshme të fshatrave dhe qyteteve. Ndonjëherë edhe qytetet përfshijnë një pjesë të një kodre ose mali dhe një pjesë të një fushe. Qytetet më të mëdha në shtetin tonë janë: Shkupi, Manastiri, Kumanova, Prilepi dhe Tetova

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRË

Mendo dhe shkruaj se cilit lloj fshati/qyteti i përkasin vendbanimet e paraqitura sipas vendit ku janë ndërtuar?



fshati Galiçnik




Kumanova



Tetova



Krusheva



Shkupi



Prilepi



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Në hartë ose në internet, zbulo se në cilën lartësi mbidetare ndodhet vendbanimi yt. Sipas lartësisë mbidetare, përcakto nëse fshati/qyteti yt ndodhet në fushë, kodër apo mal.
- Gjeji qytetet kryesore në hartën gjeografike. Me cilat shenja hartografike janë shënuar? Lexo në legjendën e hartës gjeografike dhe zbulo se cili është numri i përafërt i banorëve në ato qytete, dhe cili është numri i përafërt i banorëve në qytetin/fshatin ku jeton ti?
- Cilat vendbanime i ke vërejtur në hartën gjeografike që ndodhen më afër vendbanimit tënd? Shkruaji emrat e tyre dhe nënvizo nëse janë qytete apo fshatra!



Kontrolloj se sa mësova

1. Për cilat vendbanime themi se janë qytete, për cilat themi se janë fshatra dhe për cilat themi se janë vendbanime?

2. Të gjitha qytetet janë ndërtuar në fusha:

PO JO

3. Shëno qytetet që i keni vizituar. Për secilin qytet që e ke vizituar, shkruaj ndonjë karakteristikë të tij:

Qytete	E dalloj për nga:

PARA HARTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Zejne, Leoni dhe Violeta u mahnitën me pamjen e bukur të Pelisterit, maja më e lartë e malit

– Dëshiroja të vizitoj edhe vendet e tjera në vendin tonë, për të ditur nëse edhe atje është po aq bukur sa këtu, – tha Zejne. – Ja po ju ftoj tek unë. Unë jetoj në një qytet në rrëzë të malit Sharr. Ju mund të vini gjatë dimrit, gjatë sezonit turistik dimëror. Ndërsa gjatë verës mund ta vizitohet vëllanë tim Safetin, i cili jeton afër burimit të lumit Vardar.

– Pastaj do të vini edhe tek unë, – tha Leoni. – Unë do t'ju çoj tek ujëvara më e lartë e vendit tonë dhe më gjerë.

– Ndërsa unë ju ftoj të vizitoni liqenin më të vogël nga tri liqenet fushore natyrore që ndodhen në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Po ashtu mund ta vizitohet edhe Ponikvën, – tha Violeta.


Të zbulojmë se nga cilat vende vijnë Zejne, Leoni, Violeta dhe Safeti dhe cilat vende do t'i vizitohet.



Atdheu ynë, Republika e Maqedonisë së Veriut, është e pasur me male, fusha, lumenj dhe liqene. Një pasuri e tillë natyrore kontribuon që Republikën e Maqedonisë së Veriut të jetë vend ku zhvillohen veprimtaritë ekonomike.

MALET

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mund të veçohen rreth 40 male, shumica e të cilave janë male të ulëta dhe me lartësi mesatare, ndërkaq më pak janë malet e larta (mbi 2000 m). Malet e larta janë Mali Korab, Mali Sharr, Mali Baba, Mali Jakupicë, Mali Nixhe, Malet e Osogovës e të tjerë. Në pjesën perëndimore të vendit tonë malet janë më të larta sesa malet në pjesën lindore dhe qendrore të vendit tonë.



Mali Korab ndodhet në pjesën perëndimore të vendit tonë, në kufi me Republikën e Shqipërisë. Aty ndodhet maja më e lartë në vendin tonë, Korabi i Madh (2764 m.) Një pjesë e malit i përket parkut kombëtar “Mavrova”. Mali përshkohet me lumenj dhe përrenj më të vegjël që derdhen në lumenjtë Radika dhe Drin i Zi. Në të ndodhet ujëvara më e lartë në Ballkan, Ujëvara e Korabit (130m).



Mali Sharr ndodhet në pjesën veriperëndimore të vendit tonë në kufi me Republikën e Kosovës dhe me Republikën e Shqipërisë. Maja më e lartë e malit Sharr është Titov Vërv (Maja e Titos) (2748m). Nga qershori i vitit 2021, Mali Sharr është shpallur Park Nacional. Në Malin Sharr ndodhen 27 liqene të vogla natyrore, të cilat njihen me emrin “Sytë e Sharrit”.




Në Malin Sharr gjendet qendra turistike dimërore Kodra e Diellit, respektivisht Popova Shapka (Kapela e Priftit)

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Mali Baba ndodhet në pjesën jugperëndimore të Republikën së Maqedonisë së Veriut, në perëndim të qytetit të Manastirit. Në të është maja Pelister (2061m). Një pjesë e saj është shpallur park kombëtar “Pelisteri”. Në mal ndodhen dy liqene të quajtura Sytë e Pelisterit. Njihet gjithashtu për pishën pesëgjilpërëshe Molika, e cila është një specie shumë e rrallë në botë.

Mëso më shumë rreth Pelisterit
www.park-pelister.com.



Mali Jakupicë shtrihet në pjesën qendrore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Aty ndodhet maja Koka e Selanikut/Solunska Glava (2540m). Mali është i pasur me shumë lumenj malorë të pastër dhe të shpejtë.



Mali Nixhe ndodhet në pjesën jugore të vendit tonë. Në të është maja Kajmakçalan (2521 m). Ai është i rrethuar me pyje, kullota dhe kafshë të egra. Karakteristikë e këtij mali është se e ka formën e bumerangut.



Malet e Osogovës ndodhen në pjesën lindore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Maja më e lartë në të është Rueni (2252m). Ato janë të pasura me kullota dhe lloje të ndryshme bimësh. Qytetet më të afërta me ta janë Kriva Palanka dhe Koçani. Në të ndodhet qendra turistike Ponikva.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Ku jeton Zejne?
- Pse i fton shokët e saj ta vizitojnë gjatë dimrit?
- Zbulo si quhet qendra turistike dimërore e Malit Sharr
- Ku i ftoi Leoni shokët e tij?



DETYRË

Shkruaji në hartën memece të Republikës së Maqedonisë së Veriut shkruaji malet për të cilat mësove:





Mali i Galicicës



Kontrolloj se sa mësova

1. Të gjitha malet në Republikën e Maqedonisë së Veriut janë të llojit të maleve të larta:

PO JO

2. Maja Solunska Glava (Koka e Selanikut) ndodhet në:

- a) Malin Sharr
- b) Malin Jakupica
- c) Malet e Osogovës

3. Mali Baba është i njohur sipas:

LUMENJT DHE LIQENET

Republika e Maqedonisë së Veriut është e pasur me lumenj, liqene natyrale dhe artificiale. Ujërat janë një faktor natyror shumë i rëndësishëm për jetën e njeriut, për zhvillimin e botës shtazore dhe bimore, si dhe për zhvillimin e bujqësisë.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut njeriu lumenjtë i shfrytëzon për ndërtimin e hidrocentraleve, për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore, për zhvillimin e turizmit, për rekreacion, sport dhe peshkim..



DETYRË

Në hartën e dhënë, vëreje lumin më të gjatë në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe trego si quhet ai.




MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Vardari është lumi më i gjatë në Republikën e Maqedonisë së Veriut (388 km). Buron në fshatin Vrutok afër Gostivarit dhe derdhet në Detin Egje në Greqi. Rrjedha e tij kalon nëpër Gostivar, Shkup dhe Veles.



Radika është degë e lumit Drini i Zi dhe është një nga lumenjtë më të pastër në vendin tonë. Ai buron në pjesën veriperëndimore të majës së Vracës së Madhe, e cila ndodhet në Malin Sharr. Rrjedha e tij shkon nëpër rajonin e Rekës (afër Dibrës) nëpër vende piktoreske. Është i njohur për troftën e Radikës, e cila jeton vetëm në ujëra të pastra.



Drin i Zi buron në Shën Naum te Liqeni i Ohrit, kalon përmes Liqenit të Ohrit dhe del në qytetin e Strugës. Ai e braktis vendin tonë në qytetin e Dibrës dhe kalon në Republikën e Shqipërisë duke u derdhur në Detin Adriatik. Në ujërat e Drinit të Zi jetojnë lloje të ndryshme peshqish si trofta dhe krapi.



DETYRË

Në hartën me mëtej shkruaj emrat e lumenjve për të cilat mësove dhe të atyre që ndodhen në vendbanimin tënd.



Të dhëna interesante:

- Rrjedha e lumenjve Vardar, Crna, Treska dhe Bregalnica janë më të gjata se 100 km.
- Ngjala e Ohrit shkon nga lumi Drini i Zi në Liqenin e Ohrit për t'u mbarësuar. Rruga e saj deri në vendin e vezëve është ndërprerë për shkak të ndërtimit të dy hidrocentraleve në anën e vendit tonë dhe katër hidrocentraleve në anën e Shqipërisë.
- Burimet e fuqishme quhen gurra. Burimi më i fuqishëm në vendin tonë është burimi Ostrovo, afër manastirit Shën Naum, në Liqenin e Ohrit.
- Ekzistojnë edhe burime minerale që janë shëruese dhe për atë qëllim janë ndërtuar banja shëruese.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ekziston një numër i madh i liqeneve natyrale, shumica e të cilave janë malore dhe më të vogla, të cilat janë formuar natyrshëm. Tri liqenet më të mëdha natyrore janë: Liqeni i Ohrit, Liqeni i Prespës dhe Liqeni i Dojranit. Përveç atyre natyrore, ekzistojnë edhe liqene artificiale që u krijuan nga njeriu duke ndërtuar penda në lumenj për prodhimin e energjisë elektrike, ujitjen, zhvillimin e turizmit dhe peshkimin. Liqenet më të mëdha artificiale janë Liqeni i Mavrovës, i Kozjakut, Liqeni i Dibrës, Liqeni i Likovës, Liqeni i Tikveshit, Liqeni i Kalimancit e të tjerë..



Liqenin e Ohrit e ndajnë Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Republikën e Shqipërisë. Është liqeni më i madh natyror në vendin tonë, dhe më i vjetri në Evropë. Për shkak të numrit të madh të gjetjeve arkeologjike, historisë dhe kulturës së begatshme dhe bukurisë natyrore, ai është vendosur nën mbrojtjen e UNESCOs dhe është shpallur trashëgimi kulturore botërore. Është i njohur për troftën e Ohrit, belvicën e Ohrit dhe ujin e kthjellët, që mundëson dukshmëri deri në 22 metra thellësi.



Liqeni i Prespës është liqen natyror, të cilin e ndajnë tri shtete: Republika e Maqedonisë së Veriut, Republika e Shqipërisë dhe Republika e Greqisë. Në të ndodhen të vetmit ishujt në vendin tonë, Qyteti i Madh dhe Qyteti i Vogël, të cilët janë të mbrojtur nga shteti për shkak të rëndësisë së tyre kulturore dhe historike, por edhe për shkak të llojeve të veçanta bimore dhe shtazore.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Liçeni i Dojranit ndodhet në pjesën juglindore të vendit tonë dhe është liçeni më i vogël natyror. Ai është i rrethuar nga një rrip kallami dhe është i pasur me bimë ujore. Është i njohur për mënyrën tradicionale të peshkimit me ndihmën e rrethojave prej kallami të ashtuquajturat bulmetore.



DETYRË

Vështro hartën gjeografike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjej liçenet natyrore dhe artificiale dhe më pas shkruaj emrat e tyre në hartën “memece” të Republikës së Maqedonisë së Veriut.





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Për çfarë përdoren ujërat në vendin tonë?
- Pse është ndërprerë rruga e mbarësimit të ngjalave?
- Për çfarë është i njohur Liqeni i Prespës?
- Gjej të dhëna për thellësinë e tri liqeneve natyrore në Republikën e Maqedonisë së Veriut.
- Cilat liqene malore natyrore i njeh?



AKTIVITETI

Imagjino se je një udhërrëfyes turistik që duhet t'i prezantosh një të huaji një lumë dhe një liqen në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Bëje një pano në të cilën do t'i prezantosh dhe t'i përshkruash ata. Gjithashtu mund t'i paraqesësh edhe në formën e një prezantimi. Përdor më shumë burime përmes të cilave në mënyrë më të detajuar do ta njoftosh të huajin me bukuritë e ujërave në vendin tonë.



Kontrolloj se sa mësova

1. Në Republikën e Maqedonisë së Veriut ka liqene _____ dhe liqene _____.

2. Nëpër cilat qytete kalon lumi Vardar?

3. Lumi Vardar buron në vendin e quajtur:

- a) Ponikva
- b) Vrutok
- c) Gostivar

4. Pse Liqeni i Ohrit mbrohet nga UNESCOja?

FUSHËGROPAT



DETYRA

Me ndihmën e ngjyrave hartografike, gjej në hartën gjeografike fushat e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe emërtoji ato.

Fushëgropa është sipërfaqe e rrafshët e cila është e rrethuar me male. Për shkak të tokës pjellore me të cilën karakterizohen fushëgropat dhe pasuritë me lumenj, në to mundësohet zhvillimi i bujqësisë.



Pellagonia ndodhet në pjesën jugperëndimore të vendit tonë dhe është fushëgropa më e madhe në vendin tonë. Aty kultivohen molla, luledielli, panxhar sheqeri, por më së shumti drithërat. Kjo është arsyeja pse ajo quhet hambarë i Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Luledielli



Gruri



Panxhar sheqeri



Molla

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Ovçe Pole ndodhet në anën e majtë të lumit Vardar. Vendbanimi më i madh në atë zonë është qyteti i Sveti Nikollës. Prodhohen kultura të drithërave dhe është prodhuesi më i madh i lulediellit në vendin tonë.



Fushëgropa e Pollogut (Pollogu) ndodhet në pjesën veriperëndimore të vendit tonë dhe është një nga rajonet bujqësore më të zhvilluara në të tij. Më së shumti prodhohet fasulja, misri, gruri, lakra, qepët, specat dhe domatet.



Fasulja



Lakra



Fushëgropa e Shkupit ndodhet në pjesën veriore të vendit tonë dhe është e pasur me produkte të hershme të kopshtarisë, të rritura në serra.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



Fushëgropa e Strumicës shtrihet në pjesën juglindore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe karakterizohet me tokë të pasur dhe pjellore. Në të është e zhvilluar prodhimi i kulturave të hershme të kopshtarisë, llojeve të ndryshme të pemëve dhe perimeve në sajë të ndërtimit të sistemit për ujitje.



Fushëgropa e Tikveshit shtrihet në pjesën jugqendrore të vendit tonë dhe është e njohur për prodhimin e rrushit.



Vjelja e rrushit



MENDO DHE PËRGJIGJU


- Ku duhet të shkosh nëse dëshiron të blesh një sasi më të madhe të rrushit?
- Cilat qytete gjenden në Fushëgropën e Pollogut?
- Në cilën fushëgropë ose afër me të ndodhet vendbanimi yt?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRË

Në hartën memece shënoi fushëgropar me ngjyrë të verdhë dhe pastaj emërtoi ato!



Kontrolloj se sa mësova

1. “Hambarë i drithërave” në Republikën e Maqedonisë së Veriut është:
 - a) Fushëgropa e Pollogut
 - b) Fushëgropa e Strumicës
 - c) Fushëgropa e Pellagonisë

2. Pse bujqësia më së shumti zhvillohet në lugina?

3. Lugina më afër vendbanimit tim është _____ dhe ajo është e njohur për _____.

VENDËNDODHJA E VENDBANIMIT TIM

Zejne, Leoni dhe Violeta kanë rënë dakord të vizitonin njëri-tjetrin gjatë verës dhe dimrit.

Me siguri deri më tani e zbulove se ata planifikojnë të vizitojnë qytetin e Tetovës, vendin Vrutok, malin Korab, ujëvarën e Korabit, Liqenin e Dojranit dhe Malet e Osogovës.



AKTIVITET

Në hartën gjeografike gjeni vendet të cilat i kanë vizituar Zejne, Leoni dhe Violeta. Ndahuni në grupe dhe secili grup le të zgjedhë njërin nga vendet e përmendura. Shkruaj krejt atë që dini për ta dhe më pas secili grup le të lexojë atë që e ka shkruar. Mundohuni t'i shënoni vendet e përmendura në hartën “memece”.



AKTIVITET

Gjeje vendbanimin tënd në hartën gjeografike. Shëno se ku është në hartën dhe plotëso deklaratat e dhëna:

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Vendbanimi im është _____

Qyteti më afër tij është _____

Fshati më afër tij është _____

Lumi më afër tij është _____/Lumi
_____ kalon nëpër të.

Liqeni më afër tij është _____

Ai ndodhet në Fushëgropën e _____ Fushëgropa më
afër tij është _____

Mali/malet më i afërt/të afërta

_____ Maja më e lartë ndodhet në malin



AKTIVITET

Shkruaji letër një shoku të panjohur, me anë të së cilës do të përpiqesh të përshkruash vendndodhjen e vendbanimit tënd.



VEPRIMTARITË EKONOMIKE

Jonuzi dhe Jasmina jetojnë në fshat. Shoqja e tyre Elvira jeton në qytet. Ata mësojnë në të njëjtën shkollë dhe në të njëjtën klasë.

Një ditë ata kishin për detyrë të përshkruanin se me çfarë merreshin prindërit e tyre.

Ja çfarë shkroi Jasmina:

“Meqenëse tani është stina e pranverës, babai im filloi të mbjellë kopshtin me speca dhe domate. Gjithashtu mbolli edhe lakër. Vëllai im i madh i ndihmon. Perimet i kultivojmë me qëllim që gjatë tërë verës të kemi speca dhe domate të freskëta, ndërsa në vjeshtë do të shesim lakër. Nëna ime punon si shitëse në treg dhe i shet produktet që i prodhojmë ne”.

Jonuzi shkroi:

Nëna ime di të qëndisë shumë mirë. Ajo qep kostume popullore që shiten në të gjithë botën. Babai im punon në fermën tonë dhe rrit lopë dhe viça. Ai e përgatit qumështin dhe produktet e qumështit, të cilat pastaj i blen një kompani.

Kurse, Elvira shkroi:

Babai im punon në një fabrikë për prodhimin e pjesëve të makinave. Ai duhet të jetë shumë i kujdesshëm për të mos bërë ndonjë gabim, sepse ato janë pjesë makinash prej të cilave varet siguria e shoferëve. Nëna ime punon si inxhinierë në një kompani ndërtimi. Kompania ndërton ndërtesa, shtëpi, spitale, fabrika...



MENDO

Çfarë kanë të përbashkët tri familjet?



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Familjet e tre shokëve prodhojnë ose marrin pjesë në prodhimin e diçkaje. Ata merren me **veprimtari ekonomike**.


Këto janë veprimtari që bëjnë pjesë në krijimin e të mirave materiale. Kjo do të thotë se veprimtaritë ekonomike kanë për qëllim të prodhohet, të shkëmbehet, të shitet dhe të shpenzohet diçka.

Ekonomia është forca lëvizëse për zhvillimin e një shteti. Sa më e zhvilluar është ekonomia, aq më i fortë ekonomikisht do të jetë shteti.



DETYRË

Shqyrtoji emrat e veprimtarive ekonomike dhe mendo se me cilën veprimtari ekonomike merren prindërit e tre shokëve.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRË

Në vijat e zbrazëta shkruaj se me çka merren prindërit e tre shokëve.

Jasmina:

Nëna _____

Babai _____

Jonuzi:

Nëna _____

Babai _____

Elvira:

Nëna _____

Babai _____



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Çfarë kuptoni me nocionin bujqësi?
- Si janë të ndërlidhura mes tyre industria dhe tregtia?
- Nga se varet zhvillimi i turizmit në një vend?
- Cila veprimtari ekonomike është e zhvilluar në komunën tënde?
- Cila degë ekonomike nuk është zhvilluar fare në komunën tënde dhe shpjego arsyet pse?



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Të gjitha veprimtaritë ekonomike janë të ndërlidhura dhe të ndërvarura mes tyre. Vështro shembullin e dhënë, pastaj shkruaj një shembull me të cilin do të përshkruash lidhjen e veprimtarive ekonomike mes tyre.

BUJQËSIA

Fermeri prodhon drithëra

BLEKTORIA


Blektori përdor disa nga këto bimë për të ushqyer bagëtinë

INDUSTRIA

Qumështin që e merr nga bagëtia përpunohet në një fabrikë


TREGTIA

Qumështi që do të përpunohet në fabrikë shitet në dyqane



AKTIVITETI

Uluni në rreth. Secili prej jush tërhiqeni nga një fletëz në të cilën është shkruar emri i një veprimtarie ekonomike, por me kusht të mos e shikoni emrin e saj. Shoku pranë teje do ta ngjisë fletëzën në ballin tënd. Filloni t'u parashtroni pyetje shokëve tuaj për të zbuluar se cila veprimtari është e shënuar në fletëzën tënde. Fitues është ai i cili me më pak pyetje të parashtruara do ta zbulojë veprimtarinë ekonomike.





Kontrolloj se sa mësova

1. Dega ekonomike që merret me përpunimin e metaleve, drurit, lëkurës, tekstilit etj., quhet:

- a) bujqësi
- b) turizëm
- c) industri

2. Në cilën veprimtari ekonomike bën pjesë shitja e mobilieve?


3. Merita shkoi të blinte kos në një dyqan. Cilat veprimtari ekonomike janë përfshirë që nga fillimi i fitimit të kosit si produkt e deri në shitjen e tij?

NDËRLIDHJA E EKONOMISË ME VEÇORITË NATYRORE TË TOKËS

Pasi i lexuan shënimet e tyre Jasmina, Elvira dhe Jonuzi, shoqja e tyre Meri i pyeti Jasminën dhe Jonuzin:

– Çfarë është e nevojshme për kultivimin e perimeve, dhe çfarë është e nevojshme për prodhimin e pjesëve të automobilave?

Ndihmoni Jasminën dhe Jonuzin të shpjegojnë: Çfarë kushtesh dhe burime i duhen bujkut që të mund të prodhojë produkte bujqësore dhe çfarë kushtesh i nevojiten fabrikës për të prodhuar pjesë automobilistike?



Kujtohu:

- Pse në lugina është e zhvilluar bujqësia?
- Si janë të ndërlidhura xehetaria me industrinë?

Që të mund të zhvillohet një vend, doemos ai duhet të ketë ekonomi të zhvilluar. Zhvillimi i ekonomisë varet nga veçoritë natyrore të atij vendi. Me veçori natyrore nënkuptojmë relievin, klimën dhe burimet natyrore.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Si ndikon relievi në zhvillimin e ekonomisë?
- Cila degë ekonomike mund të zhvillohet në male?
- Cila degë ekonomike mund të zhvillohet afër liqeneve?
- A mund të zhvillohen të njëjtat degë ekonomike në male dhe në fusha?
- Si është relievi në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

RELIEVI

Relievi në Republikën e Maqedonisë së Veriut mundëson zhvillimin e degëve ekonomike që janë të ndërlidhura me pylltarinë, blegtorinë, turizmin.

Pyjet mbulojnë 39% të territorit të vendit tonë. Ato janë më të pranishme në pjesët perëndimore të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kanë më së shumti drunj lisi dhe ahu. Drunj të kanë përdorim të gjerë në ndërtimtari, në industrinë e përpunimit të drurit dhe në industrinë kimike. Shqetësues është fakti që sipërfaqet e pyjeve vazhdimisht po zvogëlohen, për shkak të prerjeve dhe përdorimit të drurit si lëndë e parë për ngrohje.

Njerëzit që jetojnë në viset malore të atdheut tonë merren kryesisht me blegtori. Ajo është një degë e rëndësishme bujqësore, përmes së cilës sigurohet mishi, qumështi dhe leshi.

Nëpër male zhvillohet edhe hoteleria dhe turizmi, ashtu që njerëzit kanë mundësi të shijojnë bukuritë e maleve dhe të merren me sport dhe rekreacion (skijim, alpinizëm, paraglajding etj.) Vendet më të njohura turistike janë Popova Shapka (Kodra e Diellit), Bistra, Kopanki në malin Baba, Krusheva në Malin e Bushës etj.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cila nga degët e përmendura ekonomike karakteristike për viset e përmendura malore është e pranishme në vendbanimin tënd?

Luginat dhe fushat në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në sajë të tokës pjellore, furnizimit të mirë me ujë dhe klimës së favorshme, mundësojnë prodhimin e pemëve, perimeve, drithërave dhe rrushit. Në sipërfaqet me ujë (lumenj dhe liqene) zhvillohet turizmi dhe hoteleria. Vendet më të njohura turistike janë Ohri, Shën Naumi, Struga, Dojrani, Liqeni i Prespës, Matka etj.

Vendi ynë është e pasur me xehe, që do të thotë se ekzistojnë kushte për zhvillimin e xehetarisë dhe shfrytëzimin e xeheve në industrinë e rëndë, por edhe për përdorimin e xeheve të qymyrit si burim energjie. Në minierat e territorit të vendit tonë nxirret xehja e bakrit, e arit, e plumbit, e zinkut, e qymyrit dhe e mermerit.



HULUMTO

Në cilat degë ekonomike qymyri përdoret si burim energjie?



Gurthyesi për nxjerrjen e mermerit në Prilep



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cila nga degët e përmendura ekonomike, karakteristike për viset fushore, zhvillohet në vendbanimin tënd?

KLIMA

Nga kushtet klimatike varet furnizimi me ujë i lumenjve dhe bota e pasur bimore dhe shtazore, gjë që është e lidhur ngushtë me zhvillimin e ekonomisë, para së gjithash, me zhvillimin e bujqësisë dhe të gjitha degëve të saj, industrisë (sidomos industrisë ushqimore, drurit dhe tekstilit), pylltarisë, komunikacionit dhe turizmit në Republikën e Maqedonisë së Veriut.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Si mund të ndikojë klima mbi zhvillimin e ekonomisë?
- Si ndikojnë periudhat pa të reshura në blegtori dhe bujqësi?



HULUMTO


Cilat degë ekonomike nuk varen nga klima në Republikën e Maqedonisë së Veriut ?



AKTIVITETI

“Diagrami i Venit”

Shkruaj dy veprimtari ekonomike. Përmes teknikës “Stuhia e mendimeve”, zbuloni se cilët faktorë janë të rëndësishëm për zhvillimin e veprimtarive që keni zgjedhur. Shkruajini ato në Diagramin e Venit. Faktorët e përbashkët shkruaj në prerjen e Diagramit. Diskutoni a ka veprimtari ekonomike që nuk kanë faktorë të përbashkët zhvillimi.



Kontrolloj se sa mësova

1. Cilat degë ekonomike janë të përbashkëta për viset malore dhe ato fushore?

2. Cilat degë ekonomike janë më të zhvilluara në viset malore?

3. Shpjegoni se si ndikon sasia e reshjeve mbi lavërtarinë.

PËRDORIMI I PËRGJEGJSHËM I BURIMEVE NATYRORE



Gjyshja Ollgicë dhe nipi i saj Pjetri po udhëtonin në pjesën jugore të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Në afërsi të qytetit Bogdanci, Pjetri ka vërejtur diçka të çuditshme.

- Shiko, gjyshe, në kodër ka rrotullues me erë, – tha ai i ngazëllyer.
- Nuk janë rrotullues me erë, por elika. Prej tyre fitohet energji elektrike, – u përgjigj gjyshja e tij.
- Pse janë ndërtuar ato?
- Ato janë ndërtuar sepse njerëzit përpiqen të përdorin burime energjie që nuk do të harxhohen. Në këtë rast ato janë helikat që e përdorin erën. Era është një nga burimet natyrore të cilën një vend e ka në dispozicion, – u përgjigj gjyshja e tij.
- Në çfarë mënyre tjetër mund t'i ruajmë burimet natyrore? – me kureshtje pyeti Pjetri.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Si duhet të sillet njeriu ndaj natyrës?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ




Shiko filmin dokumentar
“Vendi i mjaltit” dhe mendo:

Çfarë domethënie kanë fjalët e heroinës kryesore Atixhes në film: “Gjysmë për mua, gjysmë për bletët”?

Çfarë do të ndodhte nëse Atixhja do të mblidhte për vete të gjithë mjaltin nga bletët?

Gjithçka që njeriu përdor në jetën e përditshme vjen nga natyra. Ai për të jetuar përdor ujin, ajrin, tokën, bimët, kafshët. Zhvillimi i shpejtë kontribuon në shfrytëzimin akoma më të madh të burimeve natyrore. Përdorimi i pakontrolluar dhe i tepruar i burimeve natyrore e prish ekuilibrin e botës biologjike, por gjithashtu ndikon në zhvillimin më të dobët ekonomik në disa zona, rajone e më gjerë.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Çka do të thotë ekuilibri i botës biologjike?
- Pse përdorimi i pakontrolluar i burimeve natyrore mund të çojë në një zhvillim më të dobët ekonomik?

Burimet natyrore janë të rëndësishme për botën e gjallë: për njerëzit, kafshët dhe bimët. Prandaj, përdorimi i përgjegjshëm i burimeve është shumë i rëndësishëm për ekzistencën e tyre. Çfarë do të thotë përdorim i përgjegjshëm? Përdorimi i përgjegjshëm është kur çdo person dhe çdo shtet i kursen burimet natyrore dhe përdor mënyra të ndryshme për të fituar energji, të cilat do të përdorin burime të ripërtëritshme natyrore.



DETYRA

Uji është një burim pa të cilin nuk do të kishte jetë në planetin tonë. Nga ai varen bimët, kafshët dhe njerëzit.

Përgjigju pyetjeve në vazhdim:

- Çfarë do të ndodhte nëse nuk e kursejmë ujin?
- Çfarë do të ndodhte nëse i ndotim lumenjtë, liqenet, detet dhe oqeanet?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

- Shkruaj të gjitha pasojat negative për kafshët, bimët dhe njerëzit nëse:

uji nuk kursehet:

ujërat ndoten:

- Si mund të kontribuosh në kursimin e ujit dhe mirëmbajtjen e ujit të pastër?
- Si mund ta kursejnë dhe ta mirëmbajnë ujin njerëzit që merren me industri, komuna dhe qytetarët e tjerë të komunës?



DETYRA

Në jetën e përditshme ne kemi nevojë për energji elektrike. Atë e përdorim në shtëpitë tona, fabrika, spitale, punëtori, shkolla... Burimet natyrore si qymyri, nafta dhe gazi natyror digjen në termocentrale për të prodhuar energji elektrike. Djegia e tyre ndot ajrin.

Përgjigju pyetjeve:

- Si ndikon ajri i ndotur ndaj njeriut, bimëve dhe kafshëve?
- Çfarë duhet të bëjmë që të mos harxhohen burimet natyrore për prodhimin e energjisë elektrike?
- Si mund ta kursejmë energjinë elektrike
- Si mund të kontribuojnë banorët tjerë në komunë, njerëzit që merren me ekonomi dhe komuna?



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Që të shmanget harxhimi i tepërt i burimeve natyrore, si qymyri dhe nafta, dhe për të shmangur ndotjen e tepërt të mjedisit, njeriu përpiqet të gjejë burime të reja të energjisë. Ai gjen burime të tilla në burimet e ripërtëritshme të energjisë, siç janë dielli, era, uji, energjia gjeotermale dhe biomasa. Kështu gjithnjë e më shumë përdoret energjia diellore përmes instalimit të kolektorëve diellorë. Era përdoret për t'i lëvizur helikat, që prodhojnë energji elektrike. Uji përdoret për prodhimin e energjisë elektrike në hidrocentrale; energjia gjeotermale përdor ujë të nxehtë nga thellësitë e Tokës për të gjeneruar energji elektrike ose për ngrohjen e shtëpive dhe bio nafta, e cila fitohet nga biomasa dhe përdoret si lëndë djegëse për të gjeneruar energji elektrike.





DETYRA

Pyjet paraqesin pasuri të planetit tonë, të cilin duhet ruajmë. Në pyje jeton një botë e larmishme bimore dhe shtazore. Përveç që na japin ajër të pastër, drunjtë mbrojnë shtratin e lumit nga vërshimet dhe tokën nga rrëshqitja. Njeriu i përdor drunjtë për prodhimin e mobiljeve, për prodhimin e letrës, për ngrohje dhe ndërtimtari. Njeriu nuk i pret pyjet vetëm për këto nevoja, por edhe për të siguruar tokë për ndërtim. Krejt këto që u përmendën kontribuojnë në zvogëlimin e sipërfaqeve pyjore.

Përgjigju pyetjeve:

- Çfarë ndodh me botën bimore dhe shtazore të pyjeve gjatë prerjes së tyre të pakontrolluar?
- Çfarë ndodh me ajrin?
- Si mund të kontribuosh që të zvogëlohet prerja e pyjeve?
- Si mund të kontribuojnë qytetarët e tjerë?

Për të shmangur përdorimin e drurit për ngrohje, përdoren burime të tjera për ngrohje, siç janë: peletet, burimet gjeotermale, kolektorët diellorë etj. Këto janë burime të energjisë që dalin nga burimet e ripërtëritshme natyrore. Edhe letra, e përdorur më parë, mund të riciklohet dhe të përdoret rishtazi. Rolin tënd për mbrojtjen e pyjeve, ti mund ta dëshmosh me anë të mbjelljes së drunjve.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



DETYRA

Diskutoni me shokët se si mundet që edhe burimet e tjera natyrore të përdoren me përgjegjshmëri. Përmes teknikës “Stuhi idesh”, parashtroni sa më shumë propozime se si të ruhet mjedisi dhe si të përdoren burimet natyrore në mënyrë të përgjegjshme. Shkruaj idetë në postera të vegjël, të cilat do t’i vendosni brenda në shkollë dhe në oborrin e shkollës.



PËRGJIGJU PYETJEVE

- Çfarë burimesh natyrore ka komuna juaj?
- Si i përdor komuna këto burime natyrore?
- Si kontribuojnë këto burime natyrore në zhvillimin e ekonomisë së komunës suaj?



Kontrolloj se sa mësova

1. Ekzistenca e njeriut varet nga _____

2. Shkruaje një mënyrë të përgjegjshme të përdorimit të ujit:

3. Shkruaje një mënyrë të përdorimit të energjisë nga burime të ripërtëritshme natyrore.



Mersiha u kthye e lumtur nga shkolla. Sot kishin aktivitete të cilat, siç u tha mësuesi, do të kontribuojnë në ruajtjen e mjedisit. Motra e saj e vogël Lejla e pyeti se cilat ishin ato aktivitete.

– Sot mësuaam për ekologjinë dhe bëmë një poster në të cilin shkruam se si duhet të sillemi kur jemi në natyrë. Atë e vendosëm në një park aty pranë.

– Shpresoj që vizitorët do t’u përmbahen udhëzimeve, – tha Mersiha.

– Çfarë është ekologjia? – pyeti Lejla.

– Ekologjia është shkenca që merret me marrëdhëniet midis organizmave të gjallë dhe me marrëdhënien e tyre me mjedisin jetësor, – tha Mersiha.

– Do të thotë se ju në shkollë keni hulumtuar se si sillen ndër vete kafshët, bimët dhe njeriu?

– Po, dhe si duhet të sillemi ndaj mjedisit jetësor, – shtoi Mersiha.

– E si duhet të sillemi ndaj mjedisit jetësor? – pyeti Lejla.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Pse është e rëndësishme ekologjia për ne?
- Si duhet të sillemi ndaj mjedisit jetësor?

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Ne, njerëzit, planetin Tokë e ndajmë së bashku me një numër të madh të organizmave të tjerë të gjallë. Kjo na privon nga e drejta për të shkatërruar natyrën. Nga sjellja e papërgjegjshme ndaj natyrës, ne e shkatërrojmë edhe shtëpinë e organizmave të tjerë të gjallë. Secili prej nesh duhet të marrë përgjegjësinë për ruajtjen e natyrës, që atë ta përdorin edhe shumë gjenerata të tjera. Ne kemi të drejtë për një mjedis jetësor të pastër, por çfarë ndodh me obligimet tona ndaj saj?

Shihni fotografitë, mendo dhe përgjigju:



Minierë e braktisur



Deponi e egër

Në shembujt e dhënë, natyra është e ndotur dhe është prishur ekuilibri biologjik. Toka e cila është e ndotur me hemikale dhe me metale të rënda nga miniera e braktisur nuk mund të punohet më, ndërsa metalet e rënda kanë depërtuar thellë në tokë dhe i kanë ndotur ujërat nëntokësorë. Ato ujëra do të jenë të ndotura dhe të stërmbushura me substanca të dëmshme. Në to nuk do të mund të jetojnë bota bimore dhe ajo shtazore dhe gjithsesi ato do të jenë të dëmshme edhe për njeriun.

Deponitë e egra e ndotin tokën dhe ajrin. Ajri i ndotur është i dëmshëm për shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve. Mbeturinat që ndodhen në deponi janë të shpërndara dhe shumë vjet më pas do ta ndotin tokën, ajrin dhe ujin.

- Kush e ndot natyrën?
- Pse e bën atë?

Këta janë vetëm disa shembuj se si njeriu ndot dhe shkatërron natyrën.

MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Mundohuni të shkruani më tepër shembuj në të cilët vërehet ndikimi i dëmshëm i njeriut ndaj natyrës.:

Disa nga mënyrat se si mund të kontribuosh në rritjen e ndërgjegjësimit ekologjik të tjerët dhe të marrësh pjesë në ruajtjen e një mjedisi jetësor të shëndetshëm janë edhe:

- Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave;
- Mbjellja e drunjve që do të jenë pjesë e botës bimore, e cila pastron ajrin;
- Përfshirja në aksionet ekologjike.

- Me cilat mënyra të tjera mund të kontribuoni në ruajtjen e një mjedisi jetësor të shëndetshëm?

Fakte interesante:



Lumi Sitarum në Indonezi është rreth një mijë herë më i ndotur se uji i zakonshëm i pijshëm dhe përmban sasi të mëdha të substancave helmuese. Rreth 2 000 fabrika e përdorin lumin si burim uji dhe hedhin mbeturinat e tyre industriale në të.



Katastrofa ekologjike që vazhdon edhe sot e kësaj dite u shkaktua nga aksidenti në termocentralin bërthamor të Çernobilit në vitin 1986. Brenda një rreze prej 30 km rreth uzinës, toka është e ndotur dhe askush nuk jeton aty.



Kontrolloj se sa mësova

1. Ekologjia merret me:


- A) marrëdhëniet midis organizmave të gjallë dhe marrëdhënien e tyre me mjedisin
- B) sigurimin e burimeve natyrore
- C) kultivimin e bimëve

2. Si mund të kontribuosh në ruajtjen e mjedisit jetësor të shëndetshëm?

3. Kush është ndotësi më i madh i natyrës?

KLASIFIKIMI DHE RICIKLIMI I MBETURINAVE

Motra e Mersihës, Lejla, vendosi ta ndihmojë atë në përpjekjet e saj për të ruajtur natyrën dhe mjedisin jetësor. Sa herë që shkonte në piknik, ajo merrte me vete enë prej letre për ushqim të pakeluar në një qese prej pëlhere. Ajo nuk ishte dakord me shokët e saj të cilët përdornin gota dhe pjata plastike. Gjithashtu nuk ishte dakord me ta edhe kur të gjitha mbeturinat që i bënin gjatë piknikut, i hidhnin në natyrë. Ajo i mblidhte ato në qese speciale dhe rrugës për kthim në kontejnerë të veçantë.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Pse Lejla përdor enë letre?
- Pse Lejla i mblodh mbeturinat dhe i hedh në kontejnerë speciale?



Ndarja dhe riciklimi i mbeturinave është shprehi e kultivuar e njerëzve në shoqëritë e zhvilluara. Në këtë mënyrë, sasi shumë të vogla mbetjesh përfundojnë në deponi, mjedisi mbrohet dhe kursehen shumë burime. Plastika, qelqi, letra, kanaçet, metalet dhe mbeturinat organike janë hallkat më të rëndësishme në zinxhirin e riciklimit dhe ripërdorimit.

Sqarim: Të ripërdoret do të thotë të përdoret sërish ndonjë send pasi ka qenë i përdorur më parë. Ripërdorimi dhe riciklimi nuk kanë kuptim të njëjtë.

Selektimi (Ndarja) është kur mbeturinat ndahen në kontejnerë të veçantë, të destinuar për llojin e caktuar të mbeturinave, nga mbeturinat prej plastike, letre, qelqi, metali, organike. Kështu, mbetjet e ndara dërgohen në fabrika ku pastaj riciklohen. Ky është hapi i parë në mbrojtjen e planetit tonë nga ndotja



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ

Secila nga këto lloje të mbeturinave mund të ripërdoret nëse riciklohet. Kjo do të thotë se mbeturinat dërgohen në fabrikë, ku përpunohen rishtazi dhe krijohet produkt i ri. Në këtë mënyrë kursehen burimet natyrore dhe natyra mbrohet nga ndotja. Megjithëse riciklimi i mbeturinave bëhet në fabrika të caktuara, ti mund të riciklosh ose ripërdorësh gjësende, të cilat i ke përdorur më parë edhe në kushte shtëpiake.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Çka mund të ricikloni në kushte shtëpiake? Si do ta bësh këtë?
- Çka mund të ripërdorni në shtëpi e çka në shkollë?

Fakte interesante:

- Riciklimi i një ton materiale për zyrë kursen 17 trungje drunjë.
- Për ta dekompozuar një gotë prej letre (në kushte natyrore) nevojitet afër gjysmë viti, ndërsa për dekompozimin e një gote plastike duhen më shumë se 100 vjet.
- Për dekompozimin e plastikës nevojiten prej 10 deri në 50 vjet, ndërsa për dekompozimin e najlonit nevojiten 40 vjet.
- Për ta dekompozuar çamçakëzin nevojiten 20 deri në 25 vjet.
- Nga viti 2021, Bashkimi Evropian tërheq nga shitja kashtat, pjatat dhe enët plastike që përdoren për ushqim, si dhe produkte të tjera plastike që shërbejnë për një përdorim.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



AKTIVITET

Mblidhni tuba prej plastike që i përdorni në amvisëri dhe prej tyre bëni gjësende që mund të ripërdoren. Sendet e bëra ekspozoni në hollin e shkollës. Llogaritni sa tuba keni përdorur. Në këtë mënyrë ju keni ndihmuar që ato tuba të mos ndodhen në natyrë dhe të mos e ndotin atë.



AKTIVITET

Shih ku vendosen kontejnerët për selektimin e mbeturinave në komunën tuaj dhe trego se a i përdorin qytetarët si duhet kontejnerët e vendosur? Diskutoni në klasë se çfarë mund të ndërmerri për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për ndarjen e mbeturinave. Ndërmerri aksion në nivelin komunal në lidhje me përfundimet e diskutimit.



MJEDISI NË TË CILIN JETOJ



AKTIVITET

Në postera të vegjël shkruaj mesazhe për të rritur ndërgjegjësimin ekologjik tek të tjerët. Vizatoni ilustrime që paraqesin sjelljen e papërgjegjshme ndaj mjedisit jetësor dhe vendosni në kuadër të shenjës STOP. Vendosni posterat e përgatitur në një vend të dukshëm në oborrin e shkollës dhe brenda objektit shkollor.



Kontrolloj se sa mësova

1. Pse duhet të selektojmë dhe të riciklojmë?

2. Cili mund të jetë kontributi yt në ruajtjen e natyrës dhe mjedisit jetësor?




Ndotja e tokës kontribuon në përkeqësimin e shëndetit të banorëve dhe uljen e rendimenteve në bujqësi. Hulumto se si ndotet toka në komunën tuaj dhe çka ndërmerret në lidhje me të?

- Ndahuni në grupe.
- Dakordohuni për rregullat e grupeve.
- Zgjidheni nga një shok, i cili do të prezantojë në fund të hulumtimit. Gjithashtu, zgjidhni një shok që do të fotografojë atë që po e hulumtoni.
- Secili grup të hulumtojë lidhur me këtë:
 - Në cilat vende ka deponi të egra, kush i krijon ato dhe si merret komuna me to?
 - Si është rregulluar hedhja e mbeturinave në nivelin komunal?
 - Në çfarë mënyrash ndotet toka në komunë?
 - Si ndikon ndotja e tokës në rendimentet bujqësore?
 - Si ndikon ndotja e tokës në shëndetin e njeriut?

- Bëni një plan hulumtimi. Mos harroni të planifikoni materialet që do t'ju nevojiten për hulumtimin.
- Mendoni se nga cilat burime mund të mësoni dhe të siguronit më shumë informacione. Në këtë drejtim mund t'ju ndihmojnë mësuesit e biologjisë, banorët e komunës që merren me bujqësi, Kryetari/kryetarja i/e komunës, dhe punonjësit e komunës, punëtorët shëndetësorë të punësuar në spital/ ambulancë etj.
- Planifikoni cilat pyetje do t'i parashtroni gjatë zbatimit të një interviste ose anketimit të njerëzve që do t'i intervistoni ose anketoni.
- Mbani një ditar për aktivitetet.
- Në fund të hulumtimit, përmbledhni informacionin që keni marrë, ofroni një zgjidhje për problemin, bëni një prezantim dhe prezantoni punën tuaj para punonjësve në komunë dhe shokëve të shkollës suaj.





SHTETI IM

- 1 E kaluara e shtetit bashkëkohor maqedonas
- 2 Shkupi – kryeqytet
- 3 Institucionet shtetërore
- 4 Simbolet shtetërore
- 5 Karakteri multikulturor dhe multietnik i shtetit
- 6 Karakteri qytetar i shtetit
- 7 Pjesëmarrja aktive, liria e fjalës, e drejta e zgjedhjes, barazia

TEMA 3

SHTETI IM

Rezultatet e të nxënit

Pas mësimit të temës, do të jeni në gjendje:

- të numëroni dhe të përshkruaj ngjarjet e rëndësishme të së kaluarës, të cilat janë të rëndësishme për krijimin e shtetit bashkëkohor maqedonas;

- të identifikoni qytetin e Shkupit si kryeqytet dhe të përshkruaj karakteristikat e tij;

- të bëni dallimin ndërmjet institucioneve më të rëndësishme shtetërore;

- të shpjegoni karakterin multikulturor/mul-tietnik dhe qytetar të shtetit.

Ju gjithashtu do të zhvilloni:


- respektin për bashkësitë e ndryshme etnike që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;

- identitetin e qytetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



E KALUARA E SHTETIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS

KRYENGRITJA E ILINDENIT DHE REPUBLIKA E KRUSHEVËS



– Gjysh, të të pyes diçka, – tha Ilina. – Nëse do të kishe një makinë kohe, në cilin vend dhe në cilën kohë do të doje të ktheheshe prapa?

– Pyetje interesante kjo. Do të doja të kthehesha në kohën e Kryengritjes së Ilindenit, njëqind vjet prapa. Më saktësisht, më **2 gusht të vitit 1903 në Krushevë**, – tha gjyshi Dimo.


– Ooo, po kjo tingëllon si emri im dhe ka ndodhur në datëlindjen time. E di se emrin ma kanë dhënë sepse në këtë datë është Sh. Ilia. Çka do të thotë kryengritje? – pyeti e habitur Ilina.

– **Kryengritje do të thotë luftë e organizuar e njerëzve për të drejta më të mëdha.** Zakonisht ndodh për shkak të pakënaqësisë me pushtetin. Në Kryengritjen e Ilindenit, **populli maqedonas ishte i pakënaqur me pushtetin osman.** Për këtë shkak, një numër i madh bashkëmendimtarësh u dakorduan që të luftojnë për ta ndryshuar pushtetin, – shpjegoi gjyshi Dimo.

– Po pse pikërisht në Krushevë? – pyeti përsëri Ilina.

- Sepse aty kryengritësit arritën të krijojnë pushtetin e tyre dhe shtetin e vogël të ashtuquajtur **Republika e Krushevës**. Ai shtet edhe pse ekzistoi vetëm dhjetë ditë, pati rëndësi të madhe për krijimin e shtetit maqedonas, – u përgjigj gjyshi Dimo.
- Po përse vetëm dhjetë ditë? – pyeti përsëri llina.
- Sepse **osmanët e organizuan një ushtri të madhe dhe arritën t'i mposhtnin kryengritësit maqedonas dhe kështu e rikthyen pushtetin e tyre në këtë territor**, – u përgjigj gjyshi.
- Po ti çfarë do të bëje atje? – pyeti llina.
- Unë do të njihesha me Nikolla Karevin, kryetarin e parë të Republikës së Krushevës, me udhëheqësin Pitu Guli, i cili u vra trimërisht në vendin Meçkin Kamen (Gur i Ariut). Do të ndihmoja në përpunimin e më shumë topave prej qershie...
- Po Goce Dellçevi ishte atje? – përsëri pyeti llina.
- Jo, **ai u vra disa muaj para fillimit të kryengritjes, megjithatë ai mori pjesë në përgatitjen e saj. Fjalët e Goce Dellçevit: „Unë e kuptoj botën si fushë për garë kulturore midis popujve“, ishin udhërrëfyes për luftëtarët për liri drejt krijimit të shtetit maqedonas.**
- Pasi Kryengritja e llindenit nuk pati sukses të plotë, pse vallë ajo konsiderohet si shumë e rëndësishme? – pyeti llina.
- Ajo është shumë e rëndësishme për arsye se **në Kryengritje nuk luftuan vetëm maqedonasit, por edhe të gjithë të tjerët që kanë jetuar në ato hapësira**. A e di se kryengritësit nga Krusheva e shkruan një letër, në të cilën u bënë thirrje të gjithë vëllezërve dhe fqinjëve që t'i ndihmonin ata në luftën e tyre kundër armikut të përbashkët? Ata e kishin shumë me rëndësi të jetonin të gjithë së bashku, pa dallim se cilit religjion apo popull i takonin. Ajo letër në histori njihet me emrin **“Manifesti i Krushevës”**, – tha gjyshi Dimo.

JUNË E KUPTOJ BOTËN
SI FUSHË PËR GARA
KULTURORE MES
POPUJVE





A E D I N I S E:

- Porosia për bashkëjetesë, e cila dërgohet përmes Manifestit të Krushevës, i drejtohet të gjithë qytetarëve të ndershëm, pavarësisht se cilit komb apo fe i përkasin: maqedonasve, shqiptarëve, turqve, vlllehëve, serbëve, të krishterëve apo myslimanëve. Të gjithë kishin një armik të përbashkët kundër **të cilit duhej të luftonin, të çliroheshin dhe të krijonin një shtet të përbashkët. Ajo ishte Perandoria Osmane.** Disa u përfshinë dhe ndihmuan në mënyrë aktive, ndërsa të tjerët nuk morën pjesë, por nuk penguan zhvillimin e Kryengritjes me ndonjë tradhti ndaj kryengritësve.
- Anëtarët e Qeverisë së Përkohshme të Republikës së Krushevës, nga e majta në të djathtë: Vangjel Dinu, Dimitar Sekulov, Gjorgji Çaçe, Nikolla Balu, Teohar Neshkov, Hristo Qurçiev.



Nikolla Karev
kryetar i
Republikës së
Krushevës



Përpunimi i topit nga qersha

- Më poshtë është teksti original i Manifestit të Krushevës. Disa fjalë ndoshta nuk do t'i kuptoni, sepse janë të shkruara në gjuhën e vjetër maqedonase, e cila flitej në atë kohë. Me ndihmën e mësuesit/mësueses, lexoni tekstin e Manifestit ose dëgjoni versionin digjital dhe sqaroni fjalët e panjohura.

Manifesti/proklamata e Krushevës

Bashkatdhetarë dhe fqinjë të dashur!

Ne, fqinjët, miqtë dhe të njohurit tuaj të përjetshëm nga Krusheva e bukur dhe fshatrat e saj piktoreske, pa dallim feje, kombësie, gjinie e besimi, nuk mund ta durojmë më tiraninë e të eturve për gjak dhe të uritur për mish njerëzor, që na shohin dhe për të të zbritur ty në thikë, e ti dhe ne në një shkop lypësie, kurse vendi ynë i dashur dhe i pasur Maqedonia të shtrihet në një shkretëtirë të shkretë, sot ngritëm kokën dhe vendosëm me armë të mbrohem nga ata armiqtë tanë dhe tuaj dhe të fitojmë lirinë.

Ju ndoshta e dini mirë që nuk jemi keq dhe e kupton që nga halli e kemi futur kokën në thes, që të jetojmë si vëllezër në këtë tokë, të kemi miq dhe duam të mbetemi miq deri në fund.

Ne nuk ngremë armë kundër jush - kjo do të ishte turp për ne; nuk ngremë armë kundër popullit turk paqësor, punëtor e të ndershëm, që është shumë herët, si ne me djersë gjaku - ai është vëllai ynë dhe ne nuk kemi jetuar me të dhe duam të jetojmë përsëri; nuk dolëm për të therur e për të grabitur, për të djegur e për të vjedhur - na mjaftuan mizoritë e banditëve të panumërt mbi Maqedoninë tonë të varfër e të përgjakur; ne nuk dolëm për të fyer dhe çnderuar vëllezërit dhe motrat, gratë dhe vajzat tuaja; duhet ta dini se pasuria juaj, jeta juaj, besimi juaj dhe nderi juaj janë të gjitha po aq të shtrenjta sa edhe tonat. Anxhak, për të siguruar pasurinë, jetën, besimin dhe nderin, ne i morëm pushkët.

Ne nuk jemi murtatë në tokën e varfër që na ka lindur, ne nuk jemi arami e jankë, por revolucionarë të betuar se do të vdesim për të drejtën dhe për lirinë; ne rebelohemi kundër tiranisë dhe kundër skllavërisë: luftojmë dhe do të luftojmë kundër murtatëve, kundër araminjve, kundër shtypësve dhe jankesexhëve, kundër shtypësve të nderit dhe besimit tonë dhe kundër atyre që thithin djersën tonë dhe shfrytëzojnë punën tonë. Mos kini frikë nga ne dhe fshatrat tanë - ne nuk do të dëmtojmë askënd.

Ne jo vetëm që ju kemi vëllezër, por edhe na vjen keq për ju si vëllezër, sepse e kuptojmë se edhe ju jeni skllavë si ne, skllavë të mbretit dhe të begojave mbretërorë, efendive dhe pashallarëve, skllavë të të pasurve dhe të fortët, skllavë të dhunuesve dhe tiranëve, që i vunë flakën mbretërisë nga të katër anët dhe që na bënë të ngremë kokën për të drejtë, për liri dhe për jetë njerëzore. Për të drejtën, për lirinë dhe për jetën njerëzore, ju ftojme të vini të luftojmë së bashku!

Ejani, vëllezër myslimanë, të dalim kundër armiqtë tuaj dhe armiqtë tanë! Ejani nën flamurin e "Maqedonisë autonome"! Maqedonia është nëna jonë e përbashkët dhe thërret për ndihmë. Ejani të thyejmë zinxhirët e robërisë, të qajmë nga dhembja dhe vuajtja dhe le t'i thajmë lumenjtë e gjakut dhe lotëve!


Ejani te ne, vëllezër, të bashkojmë shpirtrat dhe zemrat tona dhe të shpëtojmë, që ne dhe tanët të dëshirojmë dhe të dëshirojmë të jetojmë të qetë, të punojmë të qetë dhe të përparojmë!...

Fqinjë tanë të dashur! Si turq, arnautë dhe myslimanë, e kuptojmë, të gjithë mendoni me vete se perandoria është e juaja dhe se nuk jeni skllav, pasi flamuri perandorak nuk ka kryq, por yll dhe hënë. Sepse nuk është kështu dhe ngaqë e keni gabim, shumë shpejt do ta mbani mend dhe do ta kuptoni. Por nëse dëshironi të vini te ne dhe të deklaroheni kundër tiranisë perandorake, ne, vëllezërit tuaj nga atdheu dhe nga vuajtjet, nuk do të jemi të lidhur dhe nuk do t'ju urrejme. Vetëm ne do të luftojmë për ne dhe për ju, nëse është e nevojshme, derisa të vdesim nën flamurin për lirinë tonë dhe tuajën dhe për të drejtat tona dhe tuajat. Në ballë dhe në flamurin tonë të përgjakur është shkruar "Liri ose vdekje". Tashmë e kemi ngritur atë flamur dhe nuk ka më kthim. Nëse nuk keni vëllezër si ju dhe doni të mirën tonë, nëse dëshironi të jetoni përsëri me ne, siç keni jetuar deri më tani, dhe nëse jeni bij besnikë dhe të denjë të nënës Maqedoni, mund të na ndihmoni vetëm me një gjë - dhe ky është shpërblim i madh mos luftoni me armiqtë, mos na dilni me pushkë dhe mos bëni mizori në fshatrat kristiane!

Zoti e bekoftë luftën e shenjtë për të drejtë dhe liri!

Rrofshin luftëtarët e lirisë dhe të gjithë qytetarët e ndershëm e të mirë maqedonas!

Hora! Për "Maqedoninë autonome".




MENDO DHE PËRGJIGJU

- Kujt i drejtohet letra?
- Pse kryengritësit maqedonas e shkruan atë letër?
- Çfarë porosie u dërgojnë banorëve të zonave përreth?
- Çfarë do të bëje ti po qe se do të jetoje në atë kohë?



Leximi i Manifestit të Krushevës



Makedonium, Krushevë

– Gjysh, – tha llina, – pashë fotografi të njerëzve që kanë qeverisur gjatë Republikës së Krushevës. Të gjithë janë meshkuj. Çfarë kanë bërë vajzat, nënat, gjyshet? Femrat a kanë ndihmuar në Kryengritje?
 – Si nuk na ndihmuan, – tha gjyshi Dimo. – Ato ndihmuan në shumë mënyra. Së bashku morën pjesë në përgatitjen e kryengritjes; përgatitën ushqim dhe veshje; kanë blerë armë, mbajtëse për të plagosurit, barna dhe janë kujdesur për të plagosurit; i kanë fshehur në shtëpitë e tyre për të mos u hetuar nga ushtarët osmanë. Unë kam dëgjuar për një heroinë, në moshë të shtyrë, gjyshen Para Grndarovska nga Krusheva, e cila edhe pse ishte e varfër, mori pjesë në Kryengritje me gjithë shpirt. Njerëz si ajo u bënë nëna të kryengritësve që kujdeseshin për ta kur ishin të sëmurë, lanin rrobat e tyre dhe gatuanin për ta. Disa prej tyre madje morën edhe pushkë në duar dhe u bënë luftëtare/ heroina.



Monumenti
Meçkin Kamen



Vojvoda Pitu Guli dhe çeta e tij në betejën në
Meçkin Kamen (Guri i ariut) në vitin 1903



AKTIVITET

Shih pjesë të nxjerra nga filmi artistik maqedonas Republika në flakë (<https://www.youtube.com/watch?v=uhAI2R4hWRk>; <https://www.youtube.com/watch?v=o4JoBAwU1rU>; https://www.youtube.com/watch?v=y_cjzXq0nhk), i cili e paraqet organizimin e pushtetit në Republikën e Krushevës dhe mënyrën e jetës së njerëzve në atë periudhë. Veço tre personazhe, të cilat të bëjnë më së shumti përshtypje dhe përshkruaje rolin e tyre në kryengritje.



DETYRË

Që të jetë më e qartë për ty, vizito Muzeun e Luftës revolucionare maqedonase. Aty ka figura prej dylli dhe tregime për këtë periudhë, të cilat mund t'i shohësh përmes vizitës virtuale (<http://mmb.org.mk/muzej/index.php/mk/edukacija/istrazuvame>) ose me prezencë fizike. Pastaj, me ndihmën e mësimdhënësit/es, krijoni një kënd historik me fotografi dhe objekte nga periudha e Kryengritjes së Ilindenit, dhe luani role të personazheve, të cilat ju kanë bërë me përshtypje më të madhe.



AKTIVITET

Bëni një shfaqje/dramatizim me personazhet që ju lanë përshtypje më të fortë, dhe të cilat e kishin rolin kryesor në organizimin dhe realizimin e Kryengritjes.



Kontrolloj se sa mësova:

Në pyetjet e dhëna më poshtë rretho shkronjën para fjalisë që mendon se është përgjigje e saktë:

1. Në cilën datë filloi Kryengritja e Ilindenit?
 - a. 2 gusht 1903
 - b. 2 gusht 1944
 - c. 13 nëntor 1945
 - ç. 8 shtator 1912
2. Sa kohë ekzistoi Republika e Krushevës?
 - a) Dy ditë b) 10 ditë c) Një muaj ç) 10 vjet
3. Si quhej kryetari i Republikës së Krushevës?
 - a) Dame Gruevi b) Goce Dellçevi c) Nikolla Karevi ç) Pitu Guli
4. Çfarë qëllimi kishin kryengritësit?
 - a) Të çliroheshin nga sundimi osman
 - b) Të krijonin alfabetin e tyre
 - c) Të përmirësonin mjedisin jetësor
 - ç) Të tregohen para të tjerëve
5. Si quhet letra me të cilën kryengritësit maqedonas u bëjnë thirrje të gjithë fqinjëve që t'u bashkoheshin atyre në luftën e përbashkët?
 - a) Porosia e Ilindenit
 - b) Manifesti i Krushevës
 - c) Betimi i Ilindenit
 - ç) Republika e Krushevës¹³³

KAÇKM



Gjatë pushimit të madh, një grup nxënësish bien dakord të luajnë lojën “Makina e kohës”. Ilina propozon të kthehen në Luftën e Dytë Botërore, ndërsa Florenti dhe Xheniferi menjëherë e pranojnë këtë propozim. Ata i kërkojnë mësueses që t’i lejojë të eksplorojnë në tabelën e mençur në klasë. Ajo i orienton se cilat fjalë kyçe t’i përdorin për të zbuluar gjendjen e shtetit maqedonas dhe përfitimet e tij në fund të luftës: LNÇ, KAÇKM, Metodija Andonov Çento.

Që në fillim, ata përballen me fjalë të panjohura. “Çfarë është KAÇKM?” – pyeti Xheniferi.

– Domethënë ti e di çka do të thotë LNÇ? – tha Ilina. Florenti, për t’u bërë i rëndësishëm, tha se Çento është emri i vendbanimit të tyre, dhe veç kësaj te gjyshja e tij në Prilep, në qendër të qytetit, ndodhet përmendorja e Çentos.

– Ky patjetër duhet të jetë një njeri i rëndësishëm, përderisa për të është ngritur përmendore, – u inkuadrua shoku i tyre Jovani.

– Le të shkojmë me radhë dhe të zbulojmë se çfarë nënkuptojnë dhe pse janë të rëndësishme fjalët kyçe, pastaj t’i prezantojmë ato te mësuesja, – sugjeroi Florenti. Të gjithë u pajtuan me propozimin e tij.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Çka mendon, çfarë të dhënash u fituan për personazhet e tregimit?
- A di ti diçka për fjalët kyçe që i theksoi mësuesja?

LNÇ – është shkurtesë e tri fjalëve dhe do të thotë Lufta Nacional-çlirimtare. Lufta u zhvillua gjatë Luftës së Dytë Botërore, ndërsa atë e filloi populli maqedonas për t'u çliruar nga pushteti i huaj. Porosia për bashkëjetesë, e cila ishte dërguar në kohën e Republikës së Krushevës, e përjetoi realizimin e vërtetë gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur çetat partizane u plotësuan me maqedonas dhe shqiptarë, turq, vlllehë, serbë, hebrenj... Ibe Palikuka, Bajram Shabani, Petre Piruze, Mara Naceva, Isak Sion, Qemal Agolli, Vera Aceva, Zivko Brajkovski, Qemal Sejfula Nafi Sulejmani, Dimitar Vlahov, Elpida Karamandi, Kiril Gligorov, Panko Brashnarov dhe shumë heronj e heroina të tjera luftuan për lirinë e shtetit tonë. Disa prej tyre morën pjesë në KAÇKM, ndërkaq disa e humbën edhe jetën në luftë.



PJESËMARRËSIT NË LNÇ DHE KAÇKM



AKTIVITET

Në një kuti vendosni fletushka me emrat e heronjve/heroïnave të njohura, të cilët morën pjesë në LNÇ, e që janë përmendur më lart. Së bashku me dy shokë të tjerë të klasës, tërhiqni tre emra dhe hulumtoni biografinë e tyre. Përgatitni një prezantim të përbashkët. Nëse ka më shumë nxënës në paralele, me ndihmën e mësuesit, shtoni edhe emra të tjerë të heronjve/heroïnave – pjesëmarrës (delegatë) në Mbledhjen e Parë të KAÇKM-së dhe përsëritni procedurën.



KAÇKM – është një shkurtesë e disa fjalëve, në të cilën secila fjalë ka një kuptim të caktuar. Kuvendi Antifashist për Çlirimin Kombëtar të Maqedonisë (KAÇKM) shënon kuvendin e parë maqedonas, i cili kishte të drejtë të miratonte ligje. Në atë Kuvend u krijua shteti bashkëkohor maqedonas. Mbledhja e parë e KAÇKM-së u mbajt më 2 gusht 1944 në manastirin “Sh. Prohor Pçinski”. Ajo solli vendime shumë të rëndësishme, të cilat patën rëndësi për zhvillimin e shtetit bashkëkohor maqedonas. Për shembull: gjuha maqedonase u shpall gjuhë zyrtare, të gjithë qytetarët ishin të barabartë në të drejtat e tyre, ndërkaq 11 lindenit u shpall festë shtetërore.



Metodija Andonov Çento - ishte kryetari i parë i KAÇKM-së, respektivisht presidenti i parë i Kuvendit maqedonas dhe i shtetit maqedonas

Panko Brashnarov - si delegati më i vjetër hapi sesionin e parë të ASNOM.



Disa pika të rëndësishme nga DEKLARATA E KAÇKM-së mbi të drejtat themelore të qytetarit në Maqedoninë demokratike:

- Të gjithë qytetarët e shtetit federal maqedonas janë të barabartë dhe të njëjtë para ligjit, pa dallim nga përkatësia e tyre kombëtare, gjinore, racore dhe fetare.
- Çdo qytetari i garantohet siguria personale dhe e drejta e pronës.
- Çdo qytetari i garantohet liria e fesë dhe liria e botëkuptimit.
- Të gjithë qytetarëve u garantohet liria e fjalës, shtypit, tubimit, marrëveshjes dhe liria e shoqërimit.
- E drejta e votës në Maqedoninë demokratike ushtrohet nga zgjedhësit me votim të fshehtë në bazë të së drejtës për zgjedhje të përgjithshme, të barabarta, të drejtpërdrejta dhe personale.
- Çdo qytetar dhe çdo qytetare që i ka mbushur 18 vjet ka të drejtë të votojë dhe të zgjidhet në të gjitha organet zgjedhore në pushtetin popullor, nëse nuk janë nën akuzë për kundërvajtje.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Pse Mbledhjen e Parë të KAÇKM-së ndryshe e quajnë Ilindeni i Dytë?
- Krahasoni Shpalljen e Republikës së Krushevës me vendimet e KAÇKM-së dhe shpjegoni se çfarë porosie dërgojnë këto dokumente në lidhje me të drejtat e të gjithë qytetarëve.

DEKLARATA
e KAÇKM-së për të drejtat themelore të qytetarëve
të Maqedonisë demokratike, 2 gusht të vitit 1944.

Të gjithë qytetarët e shtetit federal maqedonas janë të njëjtë dhe të barabartë para ligjeve, pavarësisht nga kombësia, gjinia, raca dhe feja e tyre.

Pakicave kombëtare të Maqedonisë u garantohen të gjitha të drejtat për jetë të lirë kombëtare. Çdo qytetari i garantohet siguria e personit dhe e pasurisë së tij, i garantohet e drejta e pronës dhe iniciativa e nderuar në jetën ekonomike. Çdo qytetari i garantohet liria e fesë dhe liria e ndërgjegjes.



Të gjithë qytetarëve u garantohet liria e fjalës, e shtypit, e tubimit, e kontratës dhe e shoqërimit. Të drejtën zgjedhore të Maqedonisë demokratike zgjedhësit e realizojnë me votim të fshehtë në bazë të së drejtës zgjedhore të përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe personale.

Të drejtën për të zgjedhur dhe të jetë i zgjedhur në të gjitha organet zgjedhore në qeverisjen popullore e ka çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeç, nëse nuk është fajtor për asnjë krim. Për sa kohë zgjat lufta nacionalçlirimtare, sipas vendimit të KAÇKM-së mund të shmanget parimi i votimit të fshehtë dhe të drejtpërdrejtë.

Çdo qytetari i garantohet e drejta për t'u ankuar kundër vendimeve të autoriteteve në mënyrën e parashikuar në ligj. Çdo qytetar ka të drejtë të kërkojë dhe të ankohet pranë të gjitha organeve shtetërore. Pushteti popullor përpiqet të eliminojë analfabetizmin dhe të ngrejë kulturën kombëtare, si dhe të sigurojë arsim falas.

Në manastirin "Shën At Prokhor Pchinski" në ILINDENT, 2 gusht i vitit 1944. Për Kuvendin Antifashist të Çlirimit Popullor të Maqedonisë.

kryetar: Metodi Andonov-Cento



Kontrolloj se sa mësova:

Në pyetjet e mëposhtme, rrethoni shkronjën para përgjigjes për të cilën mendoni se është e saktë dhe në vijën e zbrazët shkruaje përgjigjen:

1. Në cilën datë u mbajt Mbledhja e Parë e KAÇKM-së?
 - a. 2 gusht 1903
 - b. 2 gusht 1944
 - c. 13 nëntor 1945
 - ç. 8 shtator 1912.

2. Cili ishte emri i kryetarit të parë të KAÇKM-së?
 - a. Panko Brashnarov
 - b. Koço Racin
 - c. Nikolla Karev
 - ç. Metodija Andonov Çento

3. Çfarë nënkupton shkurtesa LNÇ?

4. Cilët fjalë i përmban shkurtesa KAÇKM?

5. Cili ishte vendimi i Mbledhjes së Parë të KAÇKM-së në lidhje me gjuhën maqedonase?

E KALUARA E SHTETIT BASHKËKOHOR MAQEDONAS

REFERENDUMI I PAVARËSISË

Florenti ka ardhur në vizitë te Ilina. Aty është edhe gjyshi Dimo, i cili po shikon TV. Ndërsa Ilina dhe Florenti po bisedonin me njëri-tjetrin, gjyshi Dimo, duke parë programin televiziv, në heshtje pëshpëriti:

– Sa krenar isha atëherë!

Florenti dhe Ilina e shikuan me habi.

– Çfarë tha gjyshi? Pse ishte krenar? – pyeti Ilina.

– Ejani tek unë, – i ftoi gjyshi Dimo. – Shikoni emisionin në TV: <https://www.youtube.com/watch?v=x-eriBVDDkcl>.

– Në të tregohet se si vijoi procesi i pavarësisë së shtetit tonë dhe referendumi përmes të cilit u votua pavarësia dhe mëvetësia e tij. Në atë kohë isha shumë krenar, sepse vendi ynë u bë një vend i mëvetësishëm, i pavarur dhe sovran.

– Gjysh, na shpjego pak më shumë, si u bë vendi ynë i pavarur dhe çfarë është referendumi? – pyeti Florenti.

Gjyshi Dimo filloi të shpjegojë...



- Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, Republika e Maqedonisë së Veriut ishte pjesë e një shteti të madh të Jugosllavisë, e barabartë me pesë shtete të tjera në Gadishullin Ballkanik. Më 8 shtator 1991, qytetarët në referendum u deklaruan për një shtet të pavarur dhe sovran maqedonas. Për këtë shkak ne tani 8 Shtatorin e festojmë si Dita e Pavarësisë.
- Referendumi është një pyetje që qeveria ua parashtron qytetarëve për disa vendime të rëndësishme, për të cilat nuk mund të vendosë pa i pyetur votuesit e saj. .
- Pajtohem, – u përgjigj Florenti. – Le të fillojmë.



- Kjo është interesante, – tha Ilija. – Le të mësojmë diç më shumë për referendumin dhe pavarësinë e vendit tonë. Për këtë qëllim mendoj se mund të na ndihmojnë më të moshuarit, mësuesit tanë, mund t'i pyesim edhe kustosët në muze, dhe do të ishte mirë të hulumtojmë edhe në internet.
- Pajtohem, – u përgjigj Florenti. – Le të fillojmë!



HULUMTO

- Bëje një intervistë me persona më të moshuar për krijimin e shtetit të pavarur maqedonas.
- Zbulo tri personalitete, pjesëtarë të bashkësive të ndryshme etnike, të cilët kanë kontribuar në krijimin e shtetit bashkëkohor maqedonas. Pastaj përgatit prezantim multimedial, të cilin do ta prezantosh para nxënësve të tjerë.
- Hulumto për kryetarin e parë Kiro Gligorovin dhe përgatit për të një prezantim multimedial.



Kontrolloj se sa mësova:

1. Referendumi është atëherë kur pushteti u parashtron pyetje qytetarëve për disa vendime të rëndësishme:

PO JO

2. Në cilën datë qytetarët maqedonas u deklaruan për shtet të pavarur dhe të mëvetësishëm?

- 8 shtator 1191
- 8 shtator 1991
- 8 tetor 1991
- 2 gusht 1903

3. Presidenti i parë i Maqedonsë së pavarur dhe sovrane ishte:

- Metodija Andonov Çento
- Kiro Gligorov
- Nikolla Karev
- Boris Trajkovski



DETYRË

Në afatin kohor, përcakto vendin (datën) e Kryengritjes së Ilindenit, Ses-ionin e Parë të KAÇKM-së dhe referendumin e pavarësisë. Ju mund të shtoni karaktere dhe koncepte që i lidhin ato me ngjarjet.



SHKUPI – KRYEQYTET

Te lina erdhën vizitorë nga vendet e jashtme. Ndërsa tezja Ajlin dhe e ëma e llinës po bisedonin me njëai-tjetrën, lina vendosi t'i shëtisë Meralin dhe vëllanë e saj më të madh Onisin nëpër Shkup dhe t'ua tregonte atyre monumentet kryesore të qytetit. Do t'u duhej shumë kohë për të shëtitur nëpër qytet, kështu që lina mendoi t'u tregonte disa vende më të rëndësishme, dhe për ato që nuk do të mund t'i shikonin, të hulumtonin në internet. lina filloi t'i tregonte Onisit dhe Meralit ...



Qyteti i Shkupit gjatë ekzistencës së tij, në varësi të rrethanave historike, ka pasur emra të ndryshëm. Emri antik i qytetit është Skupi. Dëshmitë më të vjetra për qytetin thonë se Shkupi ishte i banuar qysh në kohërat e lashta. Numri dhe përbërja e popullsisë vazhdimisht ka ndryshuar. Në Shkup jetojnë: maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vlllehë, serbë, boshnjakë dhe të tjerë. Në Shkup, të gjitha bashkësitë kanë jetuar gjithmonë së bashku, ndërsa deri në Luftën e Dytë Botërore këtu jetoi edhe një bashkësi tjetër e madhe – hebrejtë, të cilët tani janë në numër të vogël.



VENDI IM

Shkupi është kryeqyteti dhe qyteti më i madh i Republikës së Maqedonisë së Veriut, i shtrirë në brigjet e lumit Vardar dhe degëve të tij. Shtrihet në Fushëgropën e Shkupit, e cila është e rrethuar me malet: Vodno, Karaxhica, Osoj, Zheden dhe Mali i Zi i Shkupit. Ai shtrihet në pjesën veriore të vendit, dhe në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik.

Qyteti i Shkupit përbëhet nga 10 komuna. Ditëlindjen e vet ai e feston më 13 nëntor. Shumë herë në të kaluarën ai u shkatërrua nga luftërat, sëmundjet, përmytjet dhe tërmetet, por çdoherë ia doli të rindërtohej.



DETYRË

Së bashku me shokët dhe shoqet, shiko dokumentarin për tërmetin e Shkupit të vitit 1963 <https://www.imdb.com/title/tt0326165/>, pastaj bisedoni me mësuesin/en.

- Cilat ishin pasojat e tërmetit katastrofik?
- Si u shndërrua qyteti i Shkupit në një qytet solidariteti?
- Çfarë do të thotë të jesh solidar? Përmend shembuj nga përvoja juaj.

Pasi Ilina u tregoi Meralit dhe Onisit për Shkupin, ajo i çoi ata për një shëtitje nëpër qendrën e qytetit. Aty Merali dhe Onisi me admirim e shikuan Urën e Gurit, Kalanë dhe Çarshinë e vjetër të Shkupit. Ata gjithashtu ecën nëpër Parkun e Qytetit dhe vizituan Kopshtin zoologjik. Ata dëgjuan me interes gjërat interesante që i numëronte Ilina:.



A E DINI SE:

- Qyteti i Shkupit është selia e institucioneve më të rëndësishme shtetërore.
- Ura e Gurit është ndërtuar mbi lumin Vardar në shekullin VI. Ajo është një nga monumentet më të rëndësishme të qytetit. Ndodhet në qendër të qytetit dhe lidh pjesën e vjetër me pjesën e re të Shkupit. Sot, ura konsiderohet simbol i qytetit të Shkupit dhe është elementi kryesor i stemës së Shkupit, dhe po i njëjti është i vendosur edhe në flamurin e Shkupit.
- Për skaj Shkupit kalon edhe Akuadukti, i cili në kohërat e lashta ka shërbyer për bartjen e ujit në vendet e banuara.
- Kopshti i parë zoologjik në Ballkan u ndërtua në Shkup.
- Parku i Qytetit të Shkupit daton qysh nga fillimi i shekullit XIX. Që atëherë e deri më sot zhvillohet dhe mirëmbahet si një park që e zbukuron qytetin. Aty janë mbjellë drunj të tipit Ginkgo dhe Sekvoja, të cilat janë ndër speciet bimore më të vjetra në tërë planetin Tokë.
- Matka është liqeni artificial më i vjetër në shtetin tonë.
- Nënë Tereza si një ndër humanistet më të famshme dhe fituese e çmimit Nobël, ka lindur në Shkup. Për nder të saj është ndërtuar një qendër memoriale.

VENDI IM

Merali ishte veçanërisht e interesuar për Nënë Terezë. Ajo e dinte që kishte lindur në Shkup, por donte të dinte më shumë për të. Kështu së bashku me llinën vendosën të hulumtojnë për Nënë Terezë, dhe të bëjnë një fotoalbum me monumentet e Shkupit që ta kishin si kujtim të përbashkët.



HULUMTO

Krijo një album me fotografi (në formë letre dhe në formë elektronike) të bashkangjitur me tekst të shkurtër, përmes të cilit prezantohet qyteti i Shkupit me ndërtimet e rëndësishme, monumentet (Ura e Gurit, Kalaja e Shkupit, Çarshija e vjetër, Stacioni I vjetër hekurudhor, Hamami i Daut Pashës, Muzeu i Holokaustit, teatrot). Nëse ke mundësi, fotografo dhe bëj një fotoreportazh.



DETYRË

Vizitoheni Shtëpinë muze të Nënës Terezë (Virtualisht: <http://memorialhouseofmotherteresa.com> или физички). Punoni në grupe të formuara nga mësuesi/ja, në tekste të periudhave të ndryshme të jetës së Nënë Terezës, të cilat e paraqesin humanitetin e saj. Mësoni pasueset më karakteristike ose citatet (pjesë të tyre) dhe përgatitni poster të përbashkët. Posterit duhet të jetë produkt i punës së përbashkët i të gjithë grupeve. Pasi të jetë gati, prezantoheni para prindërve ose para nxënësve të tjerë.





Kontrolloj se sa mësova:

Në pyetjet e mëposhtme, rrethoni shkronjën para përgjigjes që mendoni se është e saktë:

1. Cili ishte emri i qytetit të Shkupit në të kaluarën?
 - a. Shkodra
 - b. Skupi
 - c. Snupi
 - ç. Sremi

2. Stacioni i vjetër i trenit dëshmon për:
 - a. vendndodhjen e qytetit të Shkupit.
 - b. përmytjen e madhe në vitin 1962.
 - c. tërmetin katastrofik në vitin 1963.
 - ç. orarin e trenave.

3. Në cilën pjesë të qytetit të Shkupit mund të shihen zejet e vjetra?
 - a. Në Muzeun e artit bashkëkohor.
 - b. Në Çarshinë e vjetër të Shkupit.
 - c. Te Hamami i Daut Pashës.
 - ç. Te Kalaja e Shkupit.

4. Si u quajt qyteti i Shkupit pas tërmetit katastrofik të vitit 1963?
 - a. Qyteti i solidaritetit.
 - b. Lulja e humanizmit.
 - c. Simboli i bukurisë.
 - ç. Qyteti i dritës.

5. Cilin tipar njerëzor e dallove te Nënë Tereza:
 - a. Kthjellësinë
 - b. Drejtësinë
 - c. Humanitetin
 - ç. Konfidencialitetin

6. Qyteti i Shkupit feston ditëlindjen e vet më:

a. 15 mars b. 13 gusht c. 13 tetor ç. 13 nëntor

INSTITUCIONET SHETËRORE




A E DINI SE:

- Shoqëria është një grup njerëzish që jetojnë së bashku dhe respektojnë rregullat e përbashkëta.
- Shteti është një territor me kufij, në të cilin ka një popullsi dhe një pushtet që udhëheq në veprimtari të ndryshme.



MËSO

- Me cilat shtete kufizohet shteti ynë? A ke qenë në ndonjërin prej tyre?
- Si duhet të sillemi në një shtet?
- Ku janë të shkruara rregullat e sjelljes në shtet?
- Kush i përcakton rregullat?
- Imagjinoni një vend ku nuk ka rregulla dhe të gjithë mund të bëjnë çfarë të duan. A do të ndiheni të sigurt?



Ligjet në shtet shërbejnë për vendosjen e rregullave të sjelljes në një lëmi të caktuar. Për shembull, Ligji për arsimin fillor garanton të drejtën për të mësuar; Ligji për mbrojtjen e mjedisit përcakton rregullat e sjelljes ndaj tij; Ligji për mbrojtje të shëndetit garanton shërimin dhe parandalimin e sëmundjeve. Ligjet në Republikën e Maqedonisë së Veriut votohen nga deputetët e Kuvendit. Gjatë kësaj procedure ata duhet ta respektojnë Kushtetutën dhe të udhëhiqen sipas saj, sepse ajo përbën ligjin më të rëndësishëm në vend. Në Kushtetutë janë të shkruara të drejtat që i kanë të gjithë qytetarët në shtet dhe obligimet e atyre që udhëheqin me të. Kështu, deputetët e kuvendit zgjidhen nga qytetarët që t'i përfaqësojnë nevojat e tyre, por edhe të sigurojnë respektimin e plotë të Kushtetutës.

Kjo është njësoj sikur kur ju në klasë zgjidhni bashkësinë e klasës dhe përfaqësues për bashkësinë e nxënësve. Ju i përzgjidhni ata përfaqësues në bashkësinë e nxënësve që sigurojnë respektimin e të drejtave tuaja në shkollë dhe për të përcjellë mendimin tuaj në parlamentin e nxënësve, te nxënësi obdusman, te drejtori i shkollës ose deri te kryetari i komunës suaj.



A, E KE DITUR SE:

Në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut shkruan se çdo qytetar, i cili i mbush 18 vjet fiton të drejtën për të votuar dhe për të zgjedhur.



HULUMTO

Pyeti më të moshuarit si votohet në zgjedhje?



AKTIVITET

Merrni pjesë në një vizitë virtuale në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes faqes së internetit të institucionit (<https://www.sobranie.mk/virtuelni-turi-niz-sobranieto.nspx>) dhe këmbeni përshtypjet tuaja me shokun tënd. Bisedoni për rolin e deputetëve dhe detyrat e tyre. Së bashku përpiloni disa fjali, të cilat do t'i prezantoni përpara nxënësve të tjerë.



Pas vizitës virtuale në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ilina dhe Arbëri diskutojnë gjatë pauzës. – Nëse ligjet dhe Kushtetuta miratohen në Kuvend, atëherë kush kujdeset për zbatimin e atyre ligjeve? Për shembull, kush është përgjegjës për punën e të gjitha shkollave në vend? Kush është përgjegjës për punën e të gjitha spitaleve dhe klinikave? – zëshëm mendont Ilina. – Po, vërtet, – konfirmoi Arbëri. – Edhe unë s’e kuptoj dot këtë. Mami shpesh përmend një lloj qeverie, ministra. A ta pyesim mësuesen tonë?“
Mësuesja u shpjegoi se ligjet i zbatojnë Ministrinë, ndërsa ato drejtohen nga ministrat. Të gjithë ministrat e përbëjnë Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

VENDI IM

- Unë mendova se kryetari i shtetit është përgjegjësi kryesor për ligjet. E di që prindërit e mi votuan për kryetar. Edhe unë isha me nënën time në qendrën e votimit, – tha Arbëri.
- Ashtu është Arbër, – tha mësuesja. – Kryetari zgjidhet nga qytetarët dhe ai është kreu i shtetit dhe njëkohësisht komandanti i përgjithshëm i forcave të armatosura. Ai është i lidhur me ligjet, ashtu që ai i miraton të gjitha ligjet që i sjell nga Kuvendi.



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Cilat kushte duhet t'i plotësojë secili që dëshiron të kandidojë për kryetar të Republikës së Maqedonisë së Veriut?



Kontrolluj se sa mësova:

1. A, mund të kandidojë për president çdo qytetar që ka mbushur moshën 18 vjeç?

PO JO

2. Kushtetuta dhe ligjet në vendin tonë i sjell:

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut
- Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë së Veriut

3. Sa vjet duhet t'i mbushësh që të jesh në gjendje të votosh në zgjedhje?

a. 14 b. 15 c. 16 ç. 18

SIMBOLET SHETËRORE

Në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin botëror në Katar, Reprezentacioni maqedonas i futbollit mudi Gjermaninë me rezultat 2:1. Para fillimit të ndeshjes, u ekzekutuan himnet e të dy vendeve. Të gjithë futbollistët dhe tifozët qëndruan gatitu, dhe ndërsa ekzekutohej himni i Republikës së Maqedonisë së Veriut, pjesëtarët e ekipit nacional maqedonas dhe tifozët e kënduan atë në një zë. Tifozët njiheshin për nga flamujt e shtetit nga i cili vijnë. Линк: www.youtube.com/watch?v=2qHp1bKZKy8



MENDO DHE PËRGJIGJU:

- Pse njerëzit qëndrojnë gatitu kur ekzekutohet himni shtetëror?
- Si duket flamuri maqedonas?
- Cilat simbole shtetërore i kanë shumica e shteteve?
- Në cilat festa ngrihet flamuri maqedonas dhe ku mund ta shohim të vendosur çdo ditë?
- Si duket stema e shtetit maqedonas?
- Në cilat ngjarje ekzekutohet himni i Maqedonisë?

Stema, himni dhe flamuri janë simbole shtetërore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.



Flamuri i Republikës
së Maqedonisë së
Veriut



Stema e Republikës
së Maqedonisë së
Veriut

Himni i Republikës së Maqedonisë së Veriut

Денес над Македонија

Денес над Македонија се раѓа,
ново сонце на слободата!
Македонците се борат
за своите правдини!
Македонците се борат
за своите правдини!
Одново сега знамето се вее
на Крушевската република!
Гоце Делчев, Питу Гули,
Даме Груев, Сандански!
Гоце Делчев, Питу Гули,
Даме Груев, Сандански!
Горите македонски шумно пеат,
нови песни, нови весници!
Македонија слободна,
слободно живее!
Македонија слободна,
слободно живее!





HULUMTO

Si duken simbolet shtetërore të fqinjëve tanë?



Kontrolloj se sa mësova:

1. Përshkruaje se si duket flamuri maqedonas

2. Shkruaji tre elemente të stemës së shtetit maqedonas

3. Cila është simbolika e himnit maqedonas?

KARAKTERI MULTIKULTUROR DHE MULTIETNIK I SHETIT

Grupi etnik është bashkësi njerëzish, pjesëtarë të një populli, që jetojnë në një shtet. Aktualisht, nuk ekziston asnjë shtet në botë në të cilin jeton vetëm një grup etnik. Grupet etnike kanë karakteristika të ndryshme që e përbëjnë kulturën e tyre: gjuha, feja, zakonet, rregullat e sjelljes, arti etj. Për shembull, në shtetin tonë jetojnë qytetarë që u përkasin kulturave dhe bashkësive të ndryshme etnike: maqedonas, shqiptarë, turq, romë, serbë, boshnjakë, vllahë dhe të tjerë. Shtete të tilla, në të cilat anëtarët e kulturave të ndryshme jetojnë së bashku, quhen shtete multikulturore. Njerëzit në to ndajnë institucionet e përbashkëta: shkollat, kopshtet, spitalet dhe bashkëpunojnë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.



AKTIVITET

• Në tabelën më poshtë, në kolonën e parë janë dhënë festat që festohen nga pjesëtarët e bashkësive të ndryshme etnike në shtetin tonë.

1. Me ndihmën e Programit për ditët jo pune në këtë vit kalendarik, i cili është publikuar në internet, plotësoje kolonën e dytë të tabelës. Shkruaj kur festohet secila nga festat e shënuara. Ki kujdes, Programin për ditët jo pune do ta përdorësh vetëm në kolonën e dytë.


2. Pastaj, duke përdorur shenjën “√”, plotëso rreshtat, si në shembullin e dhënë. Vendos shenjën në fushat e popujve/bashkësive etnike, te të cilët mendon se festohet ndonjëra nga festat e dhëna. Gjithashtu mund t'i pyesësh shokët ose mësuesen/in e tu që të të ndihmojnë. Në kolonën “të tjerë”, shkruaj nëse njih ndonjë bashkësi tjetër etnike, që feston atë festë.

Festa	Kur festohet?	Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Vllehë	Serbë	Boshnjakë	Të tjerë
Krishtlindjet		✓	✓		✓	✓	✓		Malazezë
Fitër Bajrami									
Pashkët									
Shën Kirili dhe Metodi									
Dita e Alfabetit shqip									
Dita e Arsimit turk									
Dita kombëtare e vllehëve									
Dita kombëtare e Romëve									
Ditakombëtare e Boshnjakëve									
Shën Sava Festa kombëtare e komunitetit serb									

Duke plotësuar tabelën, ti ke vërejtur se disa festa fetare në vendin tonë janë ditë jo pune për të gjitha bashkësitë etnike, por kjo nuk do të thotë se ato festohen në të gjitha familjet. Bashkësitë etnike që jetojnë në vendin tonë festojnë festat që janë karakteristike për ta si pjesëtarë të një populli, por edhe festa që lidhen me fenë. Jo të gjithë pjesëtarët e një populli kanë të njëjtën fe. Për shembull, te populli maqedonas shumica e njerëzve janë të krishterë ortodoksë, por ka maqedonas që janë katolikë, protestantë dhe myslimanë. Ekzistojnë edhe njerëz të cilët nuk janë religjiozë. Te populli shqiptar, shumica e njerëzve janë myslimanë, por ka edhe shqiptarë të krishterë ortodoksë dhe katolikë.

VENDI IM

Përkujtohu kur hulumtoje për qytetin e Shkupit. A, vërejte se Çarshia e Vjetër e Shkupit është një shembull e një vendi ku të gjithë njerëzit jetojnë së bashku, bashkëpunojnë dhe respektohen ndërmjet vete. Aty mund të provohet shumëllojshmëria e ushqimeve, mund të gjendet veshja tradicionale, mund të shihen shfaqje, të vizitohen muzetë dhe të dëgjohen të gjitha gjuhët e bashkësive etnike që jetojnë në shtetin tonë. Elementet themelore të kulturës janë: gjuha, zakonet, tradita, ushqimi, folklori etj. Me kalimin e kohës dhe jetesës së përbashkët, kulturat e ndryshme të bashkësive etnike në Republikën e Maqedonisë së Veriut kanë pasur ndikim ndaj njëra-tjetrës. Ti me siguri ke vërejtur se bashkësitë etnike kanë shumë ngjashmëri, por ato gjithashtu dallohen ndërmjet tyre sipas karakteristikave të caktuara. Njohja me njëri-tjetrin shpie në miqësi, bashkëpunim dhe respekt.



A di ti ndonjë fjalë në gjuhën e bashkësive të tjera etnike që jetojnë në shtetin tonë? Kontrolloni këtë në aktivitetin tjetër.



AKTIVITET

- Në tabelën më poshtë, në kolonën e parë, radhitni fjalët e dhëna, që do të thotë faleminderit në gjuhët e bashkësive etnike që jetojnë në shtetin tonë:
Blagodaram, Hvala, Faleminderit, Nais, Hvala, Teşekkürler, Haristo.
- Pastaj, përktheni në Google ose pyet dikë që e njeh gjuhën dhe shkruani si thuhet shok, të dua, më fal, miqësi në secilën prej gjuhëve të shënuara.
- Në kolonën “të tjerë”, nëse e dini, mund t’i shkruash këto fjalë në një gjuhë tjetër nga ato që janë dhënë në tabelë. e.

MAQEDONISHT	SHQIP	TURQISHT	ROMISHT	SERBISHT	VLEHISHT	BOSHNJAKISHT	TË TJERË
faleminderit							
shok							
të dua							
më fal							
miqësi							




MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cilat janë religjionet më të përfaqësuara në shtetin tonë?
- Cili është ndryshimi midis objekteve fetare të këtyre religjioneve?



HULUMTO

Krahaso cilat janë ngjashmëritë dhe dallimet në festimin e Bajramit dhe Pashkëve. Shkruaj shkurt rezultatet e hulumtimit tënd në diagramin e Venit.





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Çfarë vëren?
- Sa ndikuan kulturat ndaj njëra tjetrës përmes komunikimit të ndërsjellë?



A E DINI SE:

Në të gjitha kulturat dhe bashkësitë etnike ekzistojnë njerëz që nuk janë religjiozë. Njerëzit kanë të drejtë të zgjedhin që të mos i përkasin asnjë religjioni.




AKTIVITET

Vështroji fotografitë e dhëna më poshtë dhe së bashku me shokët dhe mësuesin/mësuesen përshkruaj atë që është paraqitur në secilën fotografi. Pastaj:


1. Zgjidh vetëm ato fotografi të cilat do të të ndihmojnë që të prezantosh veten dhe kulturën tënde.
2. Zgjidh fotografi me të cilat do t'i prezantosh kulturat e tjera.
3. Zgjidh fotografi me të cilat do të bësh një album për ta prezantuar shtetin tënd.

*Për secilën detyrë mund të shtosh edhe fotografi të tjera, të ndryshme nga ato që janë dhënë sipas zgjedhjes sate personale.





ABCDEFGHIJKLMNOPQRSTUVWXYZ





PËRSHKRUAJ

- Çka konkludove nga ky aktivitet?

Shiko një episod të serialit për fëmijë “Lagja jonë” dhe më pas shpjego se cilat janë përfitimet nga shoqërimi me fëmijë nga bashkësi të ndryshme etnike.



AKTIVITET

Shkruani emrin e secilës bashkësi etnike të shtetit tonë në një fletë të veçantë. Numri i fletëve duhet të korrespondojë me numrin e nxënësve në klasë, ashtu që në paralelet me numër më të madh, secila bashkësi etnike të mund të shkruhet në disa fletë. Vendosni fletëzat në një kuti dhe pastaj tërhiqni. Bëni një dyshe ose një grup me nxënësit të cilëve u ka ra bashkësia e njëjtë etnike. Secili çift ose grup hulumton për ushqimin tradicional, muzikën popullore, lojërat popullore dhe veshjen tradicionale të bashkësisë etnike që e ka tërhequr dhe pastaj le të përgatitë tekst të shkurtër të bashkangjitur me ilustrime, me të cilat do t'i vendosë në sllajde nga prezantimi multimedial. Pastaj, mësuesi/ja le t'i bashkojë sllajdet në një prezantim të përbashkët, i cili do të paraqitet para të gjithë nxënësve të paraleles dhe para vizitorëve të tjerë. Diskutoni për ngjashmëritë midis ushqimit tradicional, muzikës popullore, valleve popullore, lojërave popullore dhe veshjeve tradicionale të të gjitha bashkësive etnike. Mund të organizoni tregun shkollor me tezga të bashkësive të ndryshme etnike, me punime në të cilat do t'i inkuadroni edhe prindërit tuaj. Në qoftë se i shisni produktet, mund të bëni edhe ndonjë vepër humanitare duke e ndihmuar ndonjë shok tuajin.



Kontrolloj se sa mësova

1. Numëro bashkësitë etnike që jetojnë në shtetin tonë dhe shkruani gjuhën që ata e flasin.

2. Cilat festa lidhen me shkrim-leximin e maqedonasve, shqiptarëve dhe turqve?

3. Cilat festa i festojnë vllahët, romët dhe boshnjakët në Republikën e Maqedonisë së Veriut?

4. Shkruaj festat e rëndësishme të religjioneve më të përfaqësuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

KARAKTERI QYTETAR I SHTETIT

ORGANIZIMI QYTETAR DHE VULLNETARIZMI

Në shkollën tonë mësojnë: Jetoni, Ramizi, Sania, Maria, Rebeka dhe Roberti. Ata janë shokë. Ata gjithmonë dalin së bashku në një park aty pranë ku ngasin rolera, skejtborde ose thjesht bisedojnë me njëri-tjetrin. Për ta, gjuha nuk është pengesë për t'u shoqëruar. As besimi i ndryshëm, e as zakonet e ndryshme. Ata mësojnë nga njëri-tjetri dhe respektohen ndërmjet vete.

Ndonjëherë ata së bashku organizojnë aksion për pastrimin e parkut nga mbeturinat, ndërsa kohë më parë organizuan një aksion për krijimin dhe vendosjen e koshiqeve për ushqim për zogjtë në park. Gjatë këtij aksioni atyre u erdhi në ndihmë Shoqata qytetare “Aktivizohu”. Ajo është një shoqatë qytetare e përbërë nga qytetarë që duan të kontribuojnë në ruajtjen e një mjedisi njerëzor të shëndetshëm. Ato janë organizuar në një shoqatë qytetare, e cila punon vullnetarisht dhe ka për qëllim të zgjidhë disa probleme në komunë dhe më gjerë që kanë të bëjnë me ekologjinë, shëndetësinë, arsimin.

Jetoni, Ramizi, Sania, Maria, Rebeka dhe Roberti duan të ndihmojnë komunitetin e tyre akoma më shumë, kështu që ata vendosën të bëhen vullnetarë në Kryqin e Kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe. Këtu ata ndihmojnë për të klasifikuar rrobat dhe ushqimin e dhuruar nga qytetarët për bash-këqytetarët e tyre të cilët kanë nevojë për ushqim dhe veshmbathje. Këtë e bëjnë vullnetarisht.





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Si arrijnë këta shokë ta ruajnë shoqërinë?
- Pse ata mund të shoqërohen pa pengesa?
- A kanë të gjithë të drejtë në mënyrë të barabartë për arsimim, kujdes shëndetësor, siguri dhe mjedis jetësor të pastër? Kush ua garanton këtë të drejtë?
- Pse formohen shoqatat qytetare?
- Çfarë do të thotë fjala vullnetarizëm?



A E DINI SE:

Republika e Maqedonisë së Veriut është shtet i përbashkët i të gjithë qytetarëve që jetojnë në të, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike. Roli i shtetit është të kujdeset për realizimin e të drejtës për arsimim, mbrojtje shëndetësore, siguri dhe mjedis të pastër jetese për të gjithë qytetarët e tij. Të gjithë njerëzit janë të barabartë dhe kanë të drejta dhe liri të njëjta.

Qytetari mund t'i përmirësojë kushtet e jetesës përmes shoqërimit në baza vullnetare dhe pjesëmarrjes në aktivitete të dobishme. Por, për ta bërë këtë, ai duhet të jetë i përgjegjshëm ndaj vetvetes dhe të tjerëve dhe t'i respektojë rregullat e vendosura.

AKTIVIZO VETEN



VENDI IM

Në shkollën e Jetonit, Ramizit, Sanijes, Marias, Rebekës dhe Robertit, në mensën e shkollës për një kohë të gjatë shpërndalet ushqim jo i shëndetshëm. Me këtë janë të njoftuar edhe anëtarët e shoqatës qytetare “Aktivizohu”. Shoqata vendosi të nisë aksionin për të shpërndarë shujta të shëndetshme në shkolla, të cilat do të përmbajnë kryesisht fruta, perime, drithëra me qumësht / kos dhe lëngje të gazuara pa sheqer dhe pa aditivë. Në këtë mënyrë ata duan të kontribuojnë në përmirësimin e shëndetit të nxënësve dhe në kultivimin e shprehive për të përdorur ushqim të shëndet-shëm.





MENDO DHE PËRGJIGJU

- Çka duhet të përmbajë plani i shoqatës për zbatimin e aktivitetit lidhur me ushqimin e shëndetshëm në shkollë?
- Kush do ta realizojë aksionin?
- Si do të udhëhiqet fushata për aksionin?
- Si do të finanohet aksioni?
- Cilat do të jenë përfitimet pas përfundimit të aksionit?



AKTIVITET

Detektoni një problem në shkollën tuaj. Ndahuni në dy grupe. Secili grup le të simulojë formimin e shoqatës qytetare, e cila dëshiron ta zgjidhë problemin e detektuar. Përgatitni një plan veprimi (sigurimi i kushteve në shkollë, udhëheqje e fushatës, tërheqja e investitorëve). Në fund, paraqitni planin tuaj dhe diskutoni për përfitimet nga një shoqërim i tillë.



Kontrolloj se sa mësova:

1. Cili është qëllimi i shoqatave qytetare?

2. Çdo qytetar mund të bëjë punë vullnetare:

PO JO

3. Me anë të vullnetarizmit ndihmohen:

- a) qytetarët
- b) komunën
- c) njerëzit që kanë nevojë për ndihmë
- d) të gjitha së bashku

PJESËMARRJA AKTIVE, LIRIA E FJALËS, E DREJTA PËR ZGJEDHJE, BARAZIA

Lexo situatat e dhëna dhe mendo. Si do të veproje në situatat e përmendura?

1) Sara dhe Damjani mësojnë në një shkollë ku nuk ka rrugicë të veçantë për persona me pengesa. Ata lëvizin me karroca. Gjithashtu gjatë rrugës për në shkollë ka shumë pengesa, shkallë dhe pragje. Shoqja e tyre Besa, vuri re se Sara dhe Damjani kanë vështirësi për të hyrë në klasën ku mësojnë.



MENDO DHE PËRGJIGJU

- Cila e drejtë nuk u mundësohet Sarës dhe Damianit?
- Si mundet Besa të ndihmojë Sarën dhe Damianin që problemi të zgjidhet në mënyrë të përhershme?
- Cilat janë hapat për të ndërmarrë iniciativë për zgjidhjen e këtij problemi?
- Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtë të marrë pjesë në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve që lidhen me shëndetin, sigurinë, arsimin, mjedisin jetësor të shëndetshëm etj. Kjo do të thotë që ti si nxënës ke të drejtë për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve që lidhen me jetën shkollore dhe punën në të.

2) Bojani ka frikë të ankohej te drejtori për trajtimin e padrejtë të mësuesit/ mësueses, i cili/ e cila i shënoi notë të dobët vetëm sepse ai nuk i shkurtoi flokët.



MENDONI DHE PËRGJIGJUNI

- Çfarë të drejte nuk i jepet Bojanit?
- Si do të vepronit ju në vend të tij?
- Çfarë duhet të ndërmarrë Bojani në këtë rast?

Çdo qytetari Maqedonisë së e Maqedonisë së Veriut ka të drejtën e lirisë së fjalës. Kjo do të thotë se ju, si nxënës, keni të drejtën e lirisë së fjalës.



3) Dora është një nxënëse e shkëlqyeshme. Ajo ka shumë dëshirë të fotografojë. Në shkollë ajo shprehi dëshirë të bashkohej me foto-seksionin. Mësuesi i tha asaj se do të ishte më mirë që ajo të bashkohej me seksionin e matematikës, sepse ajo është një nxënëse e shkëlqyeshme, ndërsa shkolla nuk ka një fo-toapararat profesional dhe mjetet e nevojshme për fotografim.



MENDONI DHE PËRGJIGJUNI

- Cila e drejtë i pamundësohet Dorës?
- Si do të veproje ti po të ishe në vend të Dorës?
- Çfarë duhet të bëjë Dora në këtë rast?

VENDI IM

Çdo qytetar i Republikës së Maqedonisë së Veriut ka të drejtën e lirisë së zgjedhjes. Kjo do të thotë se nëse me zgjedhjen e tij nuk dëmton askënd, ai mund ta realizojë këtë të drejtë. Kjo do të thotë që ti, si nxënës, ke të drejtën e zgjedhjes së lirë përderisa nuk dëmton askënd dhe asgjë me zgjedhjen tënde.

4) Ilmija nuk pranohet në ekipin e hokeit sepse është femër, edhe pse luan shumë mirë. Ajo u ankua te kujdestari i klasës, por ai i tha se ekipi ishte i meshkujve dhe se ajo nuk mund të përfshihej në të.



MENDONI DHE PËRGJIGJUNI:

- Çfarë e drejte i mohohet Ilmijes?
- Si do të vepronit në vend të Ilmijes?
- Çfarë duhet të bëjë Ilmija në këtë rast?

Të gjithë qytetarët e Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë të drejta të barabarta. Kjo do të thotë që edhe ti si nxënës ke të njëjtat të drejta si nxënësit e tjerë. Ti je i barabartë me nxënësit e tjerë.

**MENDONI DHE PËRGJIGJUNI:**

Në situatat e përmendura, tregohet mosrespektimi dhe rrezikimi i të drejtave për lirinë e fjalës, për zgjedhje dhe e drejta për barazi.

- Mendo se çfarë do të bëje si nxënës nëse do të përballëshe me situata të tilla?
- Çfarë duhet të bëje ti për të zgjidhur problemet me të cilat ballafaqohet shkolla jote?
- Si mund të kontribuojnë qytetarët në zgjidhjen e problemeve të tilla?

Përfundim

Sa herë duhet të marrim ndonjë vendim, duhet të mendojmë se si ai vendim do të ndikojë te ne dhe ndaj mjedisit tonë. Për këtë arsye, ne kemi përgjegjësi për të marrë vendime të drejta, të cilat nuk do t'u shkaktojnë dëm shokëve tanë, por, përkundrazi, do të ndihmojnë në zhvillimin e klasës dhe shkollës..

